

KARTA E VLERËSIMIT

CILI ËSHTË REZULTATI
I PËRGJITHSHËM
I KOSOVËS PËR
KUJDESIN NDAJ
FËMIJËVE?



Raporti Karta e Vlerësimit është zhvilluar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, në kuadër të projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.

Publikuar nga:

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

Tetor 2024

Adresa. Sejdi Kryeziu, HY.1 K.4, Nr. 14, 10000

Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 220 287

info@komfkosova.org

FËMIJËT NË KOSOVË¹



30%

e popullsisë së përgjithshme
në Kosovë janë fëmijë

Shuma e asistencës sociale është
70 deri në **250** Euro në muaj²



36,633

fëmijë përfitues të
asistencës sociale³



46,000

fëmijë përfituan 20 Euro në
muaj dhe rreth **344,000**
fëmijë përfituan 10 Euro
në muaj⁴



Mesatarja e rasteve
për një zyrtar të
shërbimeve sociale
ishte rreth **250**
raste në vit



Strehimorja e
vetme për fëmijët
në nivel nacional u
mbyll në mungesë
të financimit⁶



634

fëmijë pa kujdes
prindëror⁷



564

raste të incidenteve
në shkolla dhe përreth
tyre⁸

VETËM

45

raste të dhunës në
shkolla të raportuara
nga shkollat në SMIA⁹

335

fëmijë, viktima të dhunës në familje,
kanë marrë shërbime nga strehimoret
gjatë 2023¹⁰

194

raste të fëmijëve të mitur në konflikt
me ligjin nën 14 vjeç¹¹

1,867

kallëzime penale të kryesve të mitur të
veprave penale¹⁴



Kalueshmëria në testin e
arritshmërisë për vitin 2023
ishte vetëm **52.1%**¹⁶

Një psikolog apo pedagog shkollor
punon me rreth **1,400** fëmijë¹⁵

Vetëm **54** institucione parashkollore/
çerdhe në sektorin publik

10 komuna nuk kanë asnjë insti-
tucion parashkollor publik

124

raste të vdekjes së
foshnjeve¹²

Vetëm 7

psikiatër për fëmijë
në institucionet
publike¹³

¹ Të dhënat e fundit për fëmijët në Kosovë

² Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

³ Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

⁴ Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

⁵ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁶ Njoftimi nga strehimorja Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët

⁷ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁸ Të dhënat nga raporti i Policisë së Kosovës, 2023

⁹ Të dhëna nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

¹⁰ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

¹¹ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

¹² Të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

¹³ Të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

¹⁴ Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit, 2023

¹⁵ Të dhëna nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

¹⁶ <https://masht.rks-gov.net/publikohen-rezultatet-e-testit-te-arritshmerise-arritshmeria-e-pergjithshme-52-1-perqind/>

TABELA E PËRMBAJTJES

Falenderime	6
Metodologjia	7
Karta e Vlerësimit: Notimi	8
Çfarë mund të mësojmë nga notat në Kartën e Vlerësimit?.....	9
MIRËQENIA SOCIALE	13
MBROJTJA E FËMIJËS	22
SHËNDETI	30
ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	39
ARSIMI	44
DREJTËSIA PËR TË MITUR	50

FALENDERIME

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, dëshiron të falenderojë të gjithë ata që kontribuan për hartimin e Kartës së Vlerësimit. KOMF është mirënjohës për të gjithë bashkë-autorët e raportit, profesionistët nga institucionet publike dhe organizatat anëtare për ofrimin e të dhënave dhe mbështetjen e tyre gjatë gjithë procesit, dhe kolegët tanë për punën e tyre të palodhur në redaktimin e raportit.

Vlerësojmë veçanërisht mbështetjen e zyrtarëve të Departamentit të Shërbimeve Sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, Shërbimit Sprovues dhe Shërbimit Korrektues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe Departamentit për Skema dhe Transfere Sociale në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Divizionit për të Drejtat e Njeriut dhe Divizionit për Arsimin Gjithëpërfshirës në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Po ashtu vlerësojmë mbështetjen e zyrtarëve të Policisë së Kosovës, Klinikës së Pediatrisë dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës për ofrimin e informacioneve dhe të dhënave të fundit zyrtare për situatën e fëmijëve.

KOMF dëshiron veçanërisht të falenderojë anëtarët e komisionit të vlerësimit të jashtëm, të cilët kontribuan me ekspertizën e tyre lidhur me përmbajtjen e raportit.

AUTORËT

Arbër Xharra, Handikos Gjakovë
Bajram Ilazi, VORAE
Besim Kodra, Shoqata për të Drejtat e Pacientëve
Donjeta Kelmendi, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Fatmire Haliti, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
Ferdane Asllani, Balkan Sunflowers Kosova
Enver Kosumi, Handikos Ferizaj
Edona Bllaca, Play International Kosovo
Gani Lluga, ASTRA
Genta Gagica, Save the Children Kosovë
Hana Zylfiu Haziri, Qendra për Arsim e Kosovës
Hatixhe Hoxha, Autizmi
Ibadete Krasniqi, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror
Klevis Vaqari, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Lekë Gjurgjiali, Organizata Zë
Loreta Keqekolla, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Lulavere Behluli, Save the Children Kosovë
Marije Vuksani, Terre des hommes në Kosovë
Mirela Lavric, Concordia
Mevlude Murtezi, Childproof Cipof
Muharrem Ademi, Qendra Labyrinth
Pajtim Zeqiri, Terre des hommes në Kosovë
Petrit Tahiri, Qendra për Arsim e Kosovës
Remzije Krasniqi, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë
Rexhep Gojnovci, Organizata Rinore AKTI
Rina Demiri Spahiu, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë
Sebahate Beqiri, Down Syndrome Kosova
Teuta Abrashi, Qendra për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
Vlorian Molliqaj, Play International Kosovo

Vlerësuesit e jashtëm:

Blerita Perolli Shehu – Eksperte për çështje sociale
Natyra Agani Destani – Eksperte për çështje psikologjike
Bedri Bahtiri – Ekspert ligjor

METODOLOGJIA

Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve? Ky është edicioni i dytë i raportit vjetor të monitorimit të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF mbi gjendjen e fëmijëve. Metodologjia e monitorimit për kontekstin e Kosovës përmes “Kartës së Vlerësimit” është zhvilluar nga eksperti ndërkombëtar për mbrojtje të fëmijëve, George Bogdanov. George është njëherit udhëheqës i Koalicionit për Mbrojtje të Fëmijëve në Bullgari, të cilët për më shumë së 10 vite tashmë e monitorojnë situatën e të drejtave të fëmijëve përmes “Kartës së Vlerësimit” dhe kanë qenë faktor motivues për KOMF për të filluar këtë proces. Ky instrument përdoret edhe nga shumë organizata të tjera të shoqërisë civile në vende të ndryshme të botës, sikurse në Irlandë, Suedi, Gjermani, Kanada, Kaliforni, etj.

Qëllimi kryesor i KOMF përmes këtij raporti është monitorimi i pavarur i shoqërisë civile në fushën e të drejtave të fëmijëve në baza vjetore, të bazuar në fakte dhe dëshmi. Raporti ofron të dhëna për gjendjen e të drejtave të fëmijëve, nivelin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe jep rekomandime, të cilat priten të mbështesin përmirësimin e politikave dhe shërbimeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Fushat në të cilat është analizuar progresi për politikën, legjislativën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe zbatimin e tyre janë: Mirëqenia sociale; Mbrojtja e fëmijës; Shëndeti i fëmijës; Zhvillimi në fëmijërinë e hershme; Arsimi dhe Drejtësia për të mitur.

Raporti përfshin fakte dhe të dhëna mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë për fushat e cekura më lart. Analiza bazohet në të dhëna dhe burime zyrtare, dhe nuk është vlerësim subjektiv i KOMF.

Burimet e të dhënave janë të cituara në referencat përkatëse. Krahas kritikës konstruktive, raporti fokusohet edhe në arritjet, si dhe ku ka pasur mangësi apo regres. Duke synuar një vlerësim sa më transparent dhe të paanshëm, është kërkuar mbështetje nga ministritë, agjencitë dhe institucionet publike në mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve mbi progresin e arritur dhe sfidat në fushat përkatëse. Më pas ky informacion i detajuar është përdorur si bazë e analizës në secilën fushë. Burimet e tjera përfshijnë të dhënat nga raportet e organizatave joqeveritare, agjencive dhe institucioneve shtetërore dhe publikimeve mediatike. Autorët në këtë raport kanë ofruar një vlerësim të fushave. Vlerësimi bazohet në sistemin e notimit sikurse notimi i nxënësve në shkollat e Kosovës, nga nota një deri në notën pesë, sikurse: nota “1 = Pamjaftueshëm”, nota “2 = Mjaftueshëm”, nota “3 = Mirë”, nota “4 = Shumë mirë” dhe nota “5 = Shkëlqyeshëm”. Autorët kanë ofruar argumentet konkrete që mbështesin notën. Duke qenë se një fushë mund të ketë më shumë se një autor, (domethënë bashkëautorë të fushave), është përdorur metoda e mesatares aritmetike, pra vlerësimet e autorëve janë përdorur për të arritur në vlerësimin përfundimtar dhe mesataren e përgjithshme të fushës. Procesi përfshin edhe vlerësuesit e jashtëm të cilët kanë ofruar po ashtu vlerësimin e tyre përmes notimit. Raporti i rënë dakord në kuadër të KOMF (pa notat e vendosura nga autorët), i është dërguar vlerësuesve të jashtëm së bashku me kriteret e vlerësimit. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga ekspertë dhe profesionistë me përvojë për fushat e trajtuara në raport. Në fund të këtij vlerësimi, është organizuar një takim i përbashkët me vlerësuesit e jashtëm, për të diskutuar dhe validuar vlerësimin përfundimtar.

KARTA E VLERËSIMIT: NOTIMI

Shkalla e notimit për fushat e trajtuara në raport është nga **1 deri në 5**, me udhëzimet përkatëse për vlerësimin dhe notimin. Vlerësimi është realizuar sipas udhëzimeve të detajuara për vlerësim, nga shqyrtimi i situatës në vend, të drejtat

e fëmijëve, politikat për fëmijët dhe familjet, vendimet dhe veprimet e marra nga institucionet për zgjidhjen e problemeve, zbatimi i këtyre vendimeve, ndikimi i tyre tek fëmijët dhe familjet.

Si bazë për vlerësimin, janë përdorur udhëzimet e mëposhtme:

Vlerësimi/Nota	Progresi
5	Institucionet shtetërore kanë zbatuar me sukses veprimet, duke realizuar me sukses masat e ndërmarra, të cilat kanë treguar efikasitet. Ky sukses ka sjellë një ndryshim të rëndësishëm, pozitiv, të qëndrueshëm dhe të dukshëm në jetën e fëmijëve dhe familjeve në Kosovë. Ky vlerësim jepet për përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve për të zbatuar me sukses veprimet, duke siguruar një ndikim pozitiv të vazhdueshëm për fëmijët dhe familjet.
4	Ka përkushtim, planifikim dhe janë ndërmarrë hapa konkretë. Ky angazhim ka ndikim për një grup të gjerë të fëmijëve. Institucionet tregojnë përkushtim duke ndjekur plane të strukturuar dhe duke kryer veprime për të adresuar sfidat. Rezultatet janë të dokumentuara për një grup të caktuar të fëmijëve. Ky vlerësim është i vlefshëm edhe në rastin kur institucionet kanë shprehur vullnet politik për zgjidhjen e problemeve dhe kanë hartuar plane për zbatimin e veprimeve, megjithatë ende nuk janë arritur rezultate për të gjithë grupin e fëmijëve të përfshirë në këto planifikime.
3	Institucionet deklarojnë se do të angazhohen në adresimin e problemeve dhe janë të gatshme për të zhvilluar plane, megjithatë, hapat e ndërmarrë vonohen, shtyhen, dhe nuk sjellin rezultatet përfundimtare të nevojshme. Në përkushtimin e tyre për zgjidhjen e çështjeve, institucionet kanë shfaqur një vullnet politik dhe kanë hartuar plane të strukturuar, megjithatë, ende nuk janë arritur rezultate për të gjithë grupet e fëmijëve për të cilët janë hartuar planet.
2	Institucionet deklarojnë se janë të përkushtuar në zgjidhjen e problemeve, megjithatë, nuk sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore, dhe ka mungesë të veprimeve reale dhe të qëndrueshme. Edhe pse institucionet kanë shprehur vullnetin për të adresuar çështjet, hapat e ndërmarrë janë minimalë, sporadikë, dhe/ose jo konsistentë, pa sjellë rezultate të dukshme. (Kjo mund t'i atribuohet mungesës së kompetencës së institucioneve shtetërore kryesore për zgjidhjen e problemeve).
1	Institucionet nuk ndërmarrin veprime konkrete për të adresuar problemet dhe nuk njohin rekomandimet për zgjidhjen e çështjeve (ato nuk janë në fokus të prioriteteve të institucionit përgjegjës). Veprimet e ndërmarra janë të gabuara dhe nuk ka rezultate. Në përgjithësi, ndonëse institucionet kanë një pozicion mbështetës, veprimet nuk kanë sjellë efektin e dëshiruar.

FUSHA	2022	2023
1. MIRËQENIA SOCIALE	2.6	2.68
2. MBROJTJA E FËMIJËS	2.5	2.52
3. SHËNDETI I FËMIJËS	2.25	2.6
4. ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	2.25	2.5
5. ARSIMI	2.5	2.33
6. DREJTËSIA PËR TË MITUR	2	2

ÇFARË MUND TË MËSOJMË NGA NOTIMI NË KARTËN E VLERËSIMIT?

MIRËQENIA SOCIALE

Nota: 2.68

Fokusi aktual i sistemit të mbrojtjes sociale i përbërë nga skemat dhe shërbimet sociale paraqet një sistem të brishtë kryesisht reaktiv, të natyrës përmirësuese dhe jo sistem parandalues për fuqizimin e familjeve dhe qytetarëve. Shteti i Kosovës ka priorizuar skemat sociale me qëllim sigurimin e mirëqenies sociale të fëmijëve dhe familjeve, ku programet e përfitimeve nga të gjitha skemat dhe shërbimet mbulojnë mbi 15% të popullsisë në Kosovë. Megjithatë, investimet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të bërë një ndryshim në popullatën e përgjithshme, në zvogëlimin e varfërisë dhe në zvogëlimin e pabarazive mes fëmijëve. Pabarazitë më të mëdha vazhdojnë të ndodhin tek fëmijët që jetojnë në varfëri, fëmijët nga komunitetet e marginalizuara, si komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Qëndrueshmëria financiare e shërbimeve sociale mbetet ndër sfidat kryesore duke rrezikuar shuarjen e shërbimeve për fëmijët dhe duke mohuar kështu të drejtat themelore për mbrojtje dhe mirëqenie të fëmijëve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Edhe pse buxheti për shërbime sociale ka pasur rritje, shërbimet sociale për fëmijët në masë të madhe vazhdojnë të mbesin në varësi të financimit nga organizatat ndërkombëtare. Progres nuk kishte në hartimin e formulës së financimit për shërbime sociale dhe miratimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal me qëllim të krijimit të Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale. Po ashtu, Projektligji për të drejtat, vlerësimin, trajtimin dhe njohjen e statusit, shërbimet dhe përfitimet për personat me aftësi të kufizuara, nuk arriti të miratohet. Arritje vlerësohet të jetë miratimi i Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili hap procesin e reformës së shërbimeve sociale si dhe fillimi i procesit të pilotimit për reformën e Skemës së Asistencës Sociale, e cila trajton diskriminimin në skemën aktuale.

MBROJTJA E FËMIJËVE

Nota: 2.52

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2020, ende nuk ka gjetur zbatim plotësisht. Shërbimet parandaluese dhe programet e parapara në këtë ligj, sikurse programet e prindërimit, shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve, linja telefonike falas për fëmijë nuk janë themeluar akoma. Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve vazhdon të jetë i fragmentuar, shërbimet mes sektorit të arsimit, mirëqenies dhe shëndetësisë nuk janë ende të integruara. Kapacitetet e limituara financiare dhe njerëzore kanë krijuar një sistem të mbrojtjes së fëmijëve, ku sistemi trajton dhe menaxhon rastet e rënda emergjente të cilëve ju rrezikohet siguria apo mirëqenia apo rastet e fëmijëve pasi kanë rënë viktimë e ndonjë forme të abuzimit. Ka mungesë të madhe të ofrimit të shërbimeve të parandalimit dhe re integritit, të cilat janë të domosdoshme për mirëqenien e fëmijëve. Si pasojë, vetëm një pjesë e fëmijëve në nevojë kanë mundësinë të përfitojnë nga shërbimet dhe programet e mbrojtjes së fëmijëve. Për më tepër për disa prej fëmijëve në nevojë për mbrojtje, sistemi ofron shërbime shumë të kufizuara, si bie fjala për fëmijët e përfshirë në punë të rënda, fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, apo fëmijët viktimë të abuzimit me substanca narkotike. Identifikimi dhe raportimi apo vetë raportimi i fëmijëve

në situata të dhunës vazhdon të jetë i ulët dhe trajtimi i rasteve të dhunës vazhdon të ketë sfida në mbrojtjen dhe rehabilitimin e tyre. Hap pozitiv konsiderohet të jetë themelimi i mekanizmave komunal për mbrojtje të fëmijëve në shumicën e komunave të Kosovës të parapara në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe miratimi 16 udhëzimeve administrative që burojnë nga ky ligj.

SHËNDETI I FËMIJËVE

Nota: 2.6

Në fushën e shëndetësisë ka mungesë të theksuar të të dhënave për fëmijët, përfshirë të dhënat për shërbimet shëndetësore të ofruara për fëmijët në sektorin privat. Vdekshmëria e foshnjave dhe fëmijëve në Kosovë është trefishi i mesatares së Bashkimit Europian, dhe më e larta në rajon. Imunizimi i fëmijëve ende nuk është në shkallën e mbulueshmërisë me vaksina të rregullta në nivelin e para Covid -19. Aktualisht nuk ka të dhëna të disponueshme nga institucionet publike për kënaqshmërinë me shërbimet shëndetësore, përkatësisht kënaqshmërinë me shërbimet shëndetësore për fëmijët. Sa i përket përkujdesjes shëndetësore konstatohet diskrepancë e madhe në mes të fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijëve nga popullsia e përgjithshme. Arritje ishte rritja e konsiderueshme e buxhetit për shëndetësinë dhe listën esenciale të barnave. Megjithatë, gjatë 2023 është evidentuar mungesa e barnave në kujdesin parësor shëndetësor, spitalet rajonale dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Projektligji për Sigurime Shëndetësore nuk arriti të miratohet, e për pasojë, shpenzimet e prindërve për trajtimin shëndetësor dhe barnat e fëmijëve vazhduan të jenë të larta. Vendi ynë vazhdon të mos sigurojë shërbime dhe programe të qëndrueshme parandaluese dhe rehabilituese për fëmijët dhe adoleshentët përdorues të substancave narkotike. Burimet në dispozicion për shëndetin mendor të fëmijëve në institucionet publike shëndetësore vazhduan të ishin shumë të kufizuara. Projektligji për ndalimin e pijeve energjike për fëmijët nuk arriti të miratohet. Statusi i organizatave jo qeveritare në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët, e sidomos fëmijët e cenueshëm vazhdon të mos jetë i rregulluar. Rregullimi i statusit të OJQ-ve si ofrues të shërbimeve shëndetësore do të rrisë qasjen në kujdesin e specializuar për popullatën e cenueshme dhe do të ndikojë në rritjen e qëndrueshmërisë së shërbimeve dhe rritjen e llogaridhënies.

ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Nota: 2.5

Megjithëse vitet e fundit Qeveria e Kosovës ka vendosur Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme, si një nga prioritetet kryesore, investimet për zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme mbeten ende të pamjaftueshme. Kosova vazhdon të ketë nivelin më të ulët të përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor krahasuar me shtetet tjera të rajonit. Një zhvillim pozitiv në aspektin e kornizës ligjore ishte miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i cili pritet të fillojë integrimin e shërbimeve ndërmjet sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Mirëpo, udhëzimet administrative që burojnë nga ky ligji, nuk janë miratuar akoma. Statistikat tregojnë se shumë fëmijë në Kosovë mbeten të privuar nga të drejtat e tyre për zhvillim në fëmijërinë e hershme dhe përballen me diskriminim bazuar në aftësi të kufizuara, etni, status socio-ekonomik dhe vendbanim. Pabarazia në qasjen në shërbime në fëmijërinë e hershme është një problem serioz në Kosovë, ku zonat rurale janë të privuara plotësisht nga këto shërbime. Edukimi dhe kujdesi në vitet e

hershme janë veçanërisht të rëndësishme për fëmijët e vegjël me aftësi të kufizuara, por ata përballen me pengesa serioze në qasjen e shërbimeve të nevojshme. Aktualisht, asnjë dokument i politikave nuk ofron bazë ligjore për shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme. Ka mungesë të programeve për identifikim dhe ndërhyrje në fëmijërinë e të hershme, e cila ndikon negativisht në zhvillimin e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Koncepti i zhvillimit në fëmijërinë e hershme vazhdon të mos jetë i qartë tek të gjithë profesionistët, duke nënkuptuar që ky koncept ka të bëjë vetëm me pjesën e edukimit, duke lënë jashtë pjesën e shëndetit dhe mbrojtjes. Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme është hartuar përgjatë vitit 2023 dhe tashmë është në proces të pilotimit.

ARSIMI

Nota: 2.33

Sistemi arsimor përballlet me sfida dhe problemetë shumta, të cilat reflektohen në rezultatet e nxënësve si dhe në vlerësimet ndërkombëtare. Kalueshmëria në Testin e Arritshmërisë për vitin 2023 ishte vetëm 52.1%. Ndërkaq, Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve "PISA" e ka renditur Kosovën në vendin e 76-të nga 80 vende pjesëmarrëse, duke shënuar rezultate të ulëta në cilësinë e arsimit. Faktorët që kontribuojnë në cilësinë e ulët të arsimit në Kosovë përfshijnë: Planprogrami i mbingarkuar; Cilësia e mësimdhënies; Numri tejet i madh i nxënësve në klasa, sidomos në qytete; Shkollat, klasat me numër shumë të vogël të nxënësve, duke përfshirë edhe klasat e kombinuara në vendet rurale; Qëndrimi për kohë të shkurtër në shkolla; Cilësia e teksteve shkollore dhe mungesa e dixhitalizimit; Mungesa e infrastrukturës adekuate; Mungesa e aktiviteteve ekstra kurrikulare; Menaxhimi jo i mirë i shkollave; Politizimi i kuadrove arsimorë; Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve; Llogaridhënia e ulët; Ndërprerjet e shumta të procesit mësimor, etj. Pavarësisht përpjekjeve të mëdha për përmirësimin e infrastrukturës, Kosova ende nuk ka arritur standardet e nevojshme për qasjen në institucionet arsimore. Shkollat ende punojnë me ndërrime, mungojnë hapësira të mjaftueshme për nxënësit dhe ka mungesë pajisjesh për laboratorë dhe punëtori. Në anën tjetër, gjendja dhe cilësia e mësimin në shkollat e vogla dhe paralelet e ndara në Kosovë është shumë e rënduar. Miratimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Ministria e Arsimit ishte hap pozitiv, mirëpo deri tani, sesionet informuese për këtë politikë janë mbajtur në vetëm katër komuna. Arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë është ende në fazë zhvillimi, me përpjekje të vazhdueshme për të krijuar një sistem arsimor që ofron mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes ose aftësive. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara vazhdon të jetë në nivel të ulët dhe mësimdhënia ende nuk i përshtatet nevojave individuale të këtyre fëmijëve. Shkollat kanë mungesë të stafit mbështetës si psikologë, pedagogë dhe asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Edhe pse është rritur mbështetja për Qendrat mësimore në komunitet, ato po përballen me vështirësi të mëdha për shkak të mungesës së fondeve, gjë që kërcënon edhe mbylljen e tyre.

DREJTËSIA PËR TË MITUR

Nota: 2

Në Kosovë vazhdojnë të mungojnë pothuajse tërësisht shërbimet për parandalimin dhe mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Qendrat për Punë Sociale vazhdojnë të mbeten me kapacitete shumë të kufizuara për të punuar me këta fëmijë e po ashtu edhe sektori joqeveritar ka mungesë të theksuar në ofrimin e këtyre shërbimeve. Themelimi i qendrave apo shtëpive të specializuara për trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, nën moshën e përgjegjësisë penale është jashtëzakonisht i domosdoshëm. Institucionet duhet të konsiderojnë mundësinë e ndarjes së dy Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës për nevojat e kësaj kategorie, nga shtatë shtëpitë e parapara në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Masat e diversitetit, të cilat janë thelbësore në nxitjen e rehabilitimit dhe reintegrimit të të miturve, vazhdojnë të zbatohen minimalisht, përkundër faktit se ato janë dyfishuar në Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Qendra Edukative e tipit të hapur vazhdon të mos bëjë pranime të drejtpërdrejta sipas vendimit të Gjykatës, por vetëm transferim nga Qendra Korrektuese për të Mitur, dhe për pasojë, të miturit me masa edukuese, vendosen në institucion të tipit të mbyllur. Kjo përbën shkelje të dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe shkelje të rëndë të të drejtave themelore të fëmijëve. Stafi profesional në të dy qendrat vazhdon të jetë i pamjaftueshëm për të ofruar shërbimet e nevojshme për rehabilitimin dhe reintegrimin e suksesshëm të të miturve. Jashtëzakonisht shqetësues është fakti që gjatë vitit 2023, stafi në Qendrën Edukuese ka rikthyer uniformat policore, prej veshjeve civile të bartura më parë. Punëtoritë për aftësim profesional në Qendrën Edukuese nuk janë funksionale për shkak të mungesës së materialeve të punës, gjë që pamundëson ofrimin e shërbimeve të nevojshme për zhvillimin dhe aftësimin profesional të të miturve.



MIRÈGENIA SOCIALE

MIRËQENIA SOCIALE

Nota: 2.68

- ▶ Sistem i mbrojtjes sociale reaktiv, sistem i natyrës përmirësuese dhe jo parandaluese
- ▶ Mungesë e një sistemi të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët pa dallim
- ▶ Transferet sociale kanë ndikim shumë të kufizuar në uljen e varfërisë së fëmijëve dhe familjeve
- ▶ Financim i paqëndrueshëm që rrezikon mbylljen e shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet



TË DHËNAT DEMOGRAFIKE DHE TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të popullsisë, numri i popullsisë rezidente në Kosovë është 1,586,65 banorë. Moshë mesatare është 34.82 vjeç (rritje për 4.85 vjet), krahasuar me vitin 2011 kur është bërë regjistrimi i fundit, ku moshë mesatare e popullsisë ishte 29.97 vjeç. Numri mesatar i anëtarëve në një ekonomi familjare është 4.5 banorë në vitin 2024, krahasuar me 5.9 banorë në një ekonomi familjare sa ishte në vitin 2011 (zvogëlim për 1.4 banorë). Ndryshimet vërehen edhe në zvogëlimin e numrit të banorëve nga 0 deri në 15 vjeç dhe rritjen e numrit të atyre mbi 65 vjeç.¹⁷ Këto të dhëna duhet të shërbejnë si bazë për krijimin e politikave për rritjen e natalitetit dhe mbështetjen e familjeve. Shkalla e papunësisë në vitin 2023 ishte 10.7%, përderisa shkalla e inflacionit ishte 2.2%. Rritja reale e Bruto Produktit Vendor në Kosovë ishte 3.96%.¹⁸

Shteti i Kosovës ka synuar avancimin e politikave dhe programeve sociale, duke prioritetizuar skemat e mbështetjes financiare me qëllim sigurimin e mirëqenies sociale të fëmijëve, familjeve dhe qytetarëve. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ka vazhduar të zbatojë skemat dhe programet me qëllim fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve, sikurse: skema e asistencës sociale për familjet në varfëri, shtesat për fëmijë, skema për mbështetjen për lehonat dhe skema për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.¹⁹ Këto politika janë pjesë e dokumenteve strategjike sikurse, Programi i Qeverisë, Plani Kombëtar për Zhvillim, Objektivat Strategjike dhe Masat për zbatimin e Programit të Qeverisë dhe planeve afatmesme dhe vjetore të punës.

¹⁷ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2023

¹⁸ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2023

¹⁹ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

²⁰ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

Programet e përfitimeve nga të gjitha skemat dhe shërbimet mbulojnë mbi 15% të popullsisë në Kosovë. Mbrojtja sociale, programet e përfitimeve në Kosovë (pensionet dhe ndihmat sociale) sipas të dhënave mbulojnë rreth 350,000 persona, që do të thotë mbi 15% e popullsisë kanë qasje në njërin nga skemat e pagesave sociale të menaxhuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.



15%

E POPULLSISË KANË QASJE NË NJËRËN NGA SKEMAT E PAGESAVE SOCIALE

Bazuar në skemat aktuale, ndarjet buxhetore për mbulimin e pagesave për vitin 2023 arrijnë në mbi 800 milionë Euro, që do të thotë mbi 20% të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2023. Krahasuar me vitin paraprak 2022, konstatohet rritje e buxhetit për skemat sociale, ku në vitin 2022, buxheti për skemat sociale ishte mbi 600 milionë Euro.²⁰

Përkrahja sociale vazhdon të jetë e orientuar drejt ndihmës monetare mujore në kuadër të skemave sociale. Ndërsa, vazhdon të ketë mungesë të theksuar të programeve për mbështetje dhe fuqizim të familjeve, përmes ofrimit të shërbimeve të nevojshme.

VARFËRIA E FËMIJËVE DHE PROGRAMET PËR FUQIZIM TË FAMILJES

Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të fëmijëve që jetojnë në varfëri. Shqetësuese mbetet mungesa e të dhënave për shkallën e varfërisë në nivel vendi, e posaçërisht varfërisë së fëmijëve. Të dhënat e fundit datojnë nga viti 2019, ku sipas tyre 22.7% e fëmijëve jetojnë në varfëri, ndërsa 7% jetojnë në varfëri ekstreme.



22.7%

E FËMIJËVE JETOJNË NË VARFËRI, NDËRSA 7% JETOJNË NË VARFËRI EKSTREME.

Pabarazitë më të mëdha vazhdojnë të ndodhin tek fëmijët më të varfër, fëmijët nga komunitetet e marginalizuara, si komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.²¹

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka vazhduar të implementojë skemat me qëllim zvogëlimin e varfërisë dhe fuqizimin e familjeve në Kosovë. Programet apo skemat kryesore për mbështetjen e familjeve ishin Skema e Asistencës Sociale, Shtesat për Fëmijë, programi mbështetës për lehonat e papuna dhe lehonat e punësuar dhe skema për mbështetjen e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar.²² Sa i përket programit për mbështetjen e lehonave, rreth 8,000 lehona të papuna u mbështetën në shumë prej 170 Euro për 6 muaj dhe rreth 1,800 lehona të punësuar u mbështetën në shumë prej 170,00 Euro për 3 muaj.²³

Qeveria e Kosovës, përmes disa programeve me mbështetje edhe nga donatorët është angazhuar në zbatimin e masës për punësimin e së paku një anëtari të familjes për familjet që nuk kanë të punësuar, angazhimin në punësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe përfshirjen e të rinjve në kuadër të

punësimit. Këto janë zbatuar përmes masave të programit të ringjalljes ekonomike dhe programeve të tjera. Megjithatë, nuk ka të dhëna për numrin e përfituesve të angazhuar nga kategoria e përfituesve të skemës së asistencës sociale në kuadër të zbatimit të këtyre masave.²⁴

Investimet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të bërë një ndryshim në popullatën e përgjithshme, në zvogëlimin e varfërisë dhe në zvogëlimin e pabarazive mes fëmijëve. Zgjerimi i programeve për zvogëlimin e varfërisë dhe fuqizimin e familjes, sigurimi i qasjes së barabartë në shërbime, dhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm janë hapa të domosdoshëm për përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve të cënueshme në Kosovë.

SKEMA E ASISTENCËS SOCIALE



36,633

FËMIJË PËRFITUAN NGA ASISTENCA SOCIALE

Programi kryesor për mbështetjen e familjeve gjatë vitit 2023 ishte programi i asistencës sociale, ku 20,364 familje me 79,925 anëtarë kanë përfituar në baza mujore, prej tyre 36,633 ishin fëmijë. Shuma e asistencës sociale ishte nga 70 deri në 250 Euro në muaj, shumë kjo e pamjaftueshme për të përballuar kushtet elementare të jetesës për një familje, sidomos me inflacionin e ndodhur në vitin 2023.²⁵

Një numër i familjeve dhe fëmijëve që jetojnë në gjendje të rëndë socio ekonomike, nuk janë pjesë e përfitimeve nga skema e asistencës sociale për shkak të kriterëve në Ligjin për Asistencë Sociale.²⁶ Kjo vërteton që skema e asistencës sociale nuk është mirë e adaptuar dhe nuk përfshin të gjithë fëmijët dhe familjet që jetojnë në varfëri. Aktualisht nuk ka të dhëna për numrin e familjeve që jetojnë në varfëri e që nuk përfitojnë nga asistenca sociale.²⁷

²¹ Të dhënat nga Balkan Sunflowers Kosova, Down Syndrome Kosova, Autizmi, 2023

²² Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

²³ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

²⁴ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

²⁵ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

²⁶ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

²⁷ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

Si pasojë e disa prej kriterëve të Ligjit për Asistencë Sociale, një numër i ekonomive familjare nuk kanë mundësi të përfitojnë nga skema e asistencës sociale. Kriteret përjashtuese dhe diskriminuese janë kriteri i moshës së fëmijëve për kategorinë e II-të, konfirmimi dhe vlerësimi që anëtarët e ekonomisë familjare t'i nënshtrohen vlerësimeve të komisioneve mjekësore për aftësinë e mbetur për punë, mungesa e identifikimit të të hyrave dhe të ardhurave të sakta për të matur nivelin e mirëqenies së ekonomive familjare, etj.²⁸ Kriteri (i) në Kategorinë e II, Neni 4, ku përcaktohet që familja duhet të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç, është diskriminues dhe absolutisht i papranueshëm nga të gjithë akterët e përfshirë në skemë por edhe nga vetë përfituesit. Sipas këtij kriteri familjet në varfëri që nuk kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare bien në pozitë të pafavorshme, ky kriter përjashton edhe familjet që kanë marrë asistencë sociale deri sa fëmija ka mbushur moshën 5 vjeç, pikërisht kur fëmija duhet të fillojë të shkollohet dhe rrjedhimisht dhe familja do të ketë shpenzime edhe më të mëdha.²⁹

Këto mangësi pritet të eliminohen me legjislacionin e ri të Skemës së Asistencës Sociale që planifikohet të aprovet në vitin 2024. Duhet theksuar që procesi i hartimit të Ligjit për Asistencën Sociale ka filluar prej pesë vitesh dhe akoma nuk është miratuar. Kriteret diskriminuese për fëmijët pritet të largohen dhe të krijohen mundësitë që ekonomitë familjare me të ardhura të ulëta nën nivelin e përcaktuar, të mund të përfitojnë nga mbështetja e skemës së asistencës sociale. Hap pozitiv konsiderohet fillimi i zbatimit të projektit të reformës së skemës së ndihmës sociale të financuar nga kredia e Bankës Botërore dhe përgatitja e Projektligjit për Skemën e Ndihmës Sociale dhe Mbrojtje Sociale, në kuadër të cilit është planifikuar edhe rregullimi ligjor i shtesave për fëmijë dhe përfitimeve për lehonat e papunësuar. Bazuar në Ligjin për Asistencë Sociale në fuqi, aktualisht 50% e familjeve janë me fëmijë të cilat përfitojnë edhe një shtesë prej 10 euro si pjesë e ekonomisë familjare.³⁰

Mbështetje tjetër për familjet është ofruar edhe përmes programit të ringjalljes ekonomike dhe implementimit të Masës 3.4 – Mbështetje financiare për OJQ-të dhe entitetet e

tjera që ofrojnë shërbime sociale për kategoritë e cenusshëm të shoqërisë, përmes kuzhinave popullore.³¹

Fokusi aktual i skemave dhe shërbimeve sociale paraqet një sistem të brishtë të shërbimeve sociale dhe mirëqenies sociale kryesisht të natyrës përmirësuese, duke ofruar kujdes reaktiv në vend se parandalues për fuqizimin e familjeve. Sistemi duhet fuqizuar për të synuar krijimin e sistemit proaktiv dhe reagues. Sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë, ndonëse ofron një ndihmë financiare, nuk arrin të adresojë në masën e mjaftueshme nevojat e ndryshme të familjeve dhe fëmijëve të cenusshëm. Është e domosdoshme të krijohet një qasje më gjithëpërfshirëse për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet e mbështetjes dhe fuqizimin e plotë të familjes. Po ashtu, është më se e domosdoshme integrimi i skemës së asistencës sociale me shërbimet sociale, zyrat për punësim, shërbimet shëndetësore dhe ato arsimore.

SHTESAT PËR FËMIJË



46,000

**FËMIJË PËRFITUAN SHTESA 20 EURO NË MUAJ DHE
MBI 344,000 FËMIJË 10 EURO NË MUAJ**

Bazuar në të dhënat, përmes sistemit online të integruar të Platformës E – Kosova, përgjatë vitit 2023 kanë përfitur nga shtesat për fëmijë mbi 46,000 fëmijë në shumën prej 20 Euro në muaj dhe mbi 344,000 fëmijë në shumën prej 10 Euro në muaj.³² Shuma mujore e ndarë është e ulët, nuk është e mjaftueshme për të përballuar nevojat e fëmijëve.

²⁸ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

²⁹ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF, 2023

³⁰ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

³¹ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

³² Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

Shtesat për fëmijë Masa 3.5 – Viti 2023		
Muaji	Nr. i fëmijëve (0 - 24 muaj)	Nr. i fëmijëve (nën 16 vjeç)
Janar	43,709	271,064
Shkurt	44,210	286,738
Mars	44,472	295,573
Prill	44,439	300,298
Maj	44,585	304,315
Qershor	44,477	307,404
Korrik	44,463	310,353
Gusht	44,735	315,011
Shtator	44,513	325,154
Tetor	45,161	328,882
Nëntor	45,355	331,388
Dhjetor	46,320	344,680

Skema e shtesave për fëmijë nuk është gjithëpërfshirëse, pasi përfshinë fëmijët deri në moshën 16 vjeçare. Legjislacioni në Kosovë por edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës përcakton moshën e fëmijës deri në moshën 18 vjeçare. Përfshirja e të gjithë fëmijëve është e nevojshme sidomos duke pas parasysh faktin që aktualisht nuk ka ndonjë skemë të aplikueshme për mbështetjen e fëmijëve të moshës 16 – 18 vjeçare.

Shqetësuese mbetet fakti që fëmijët pa kujdes prindëror në familjet strehuese nuk gëzojnë këtë të drejtë dhe nuk përfitojnë nga shtesat për fëmijë. Nga viti 2021, kur është filluar me ofrimin e shtesave për fëmijët, fëmijët pa kujdes prindëror nuk kanë përfituar për shkak që kujdestarët ligjorë të fëmijëve në kuadër të Qendrave për Punë Sociale nuk kanë mundur të realizojnë aplikimin për arsye të mungesës së llogarive bankare zyrtare dhe statusit të Qendrës për Punë Sociale.³³

Po ashtu, shtesat për fëmijë nuk kanë një bazë ligjore të qëndrueshme, ofrohen bazuar në një vendim në kuadër të pakos emergjente nga periudha Covid – 19 në vitin 2021.

PËRKRAHJA E FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ligji për Përkrahje Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme ofron një ndihmë monetare prej 100 Euro në muaj për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme. Megjithatë, ky ligj nuk garanton mbrojtje gjithëpërfshirëse për të gjitha familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, por njeh të drejtën për kompensim material vetëm për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme fizike, mendore dhe shqisore, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër.³⁴ Ky ligj ofron mbështetje për vetëm rreth 3,000 fëmijë me aftësi të kufizuara.³⁵ Prandaj, si i tillë ai bën diskriminim dhe nuk mbulon të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara. Për më tepër, mbështetja financiare prej 100 Euro është e pamjaftueshme për nevojat e familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Shuma mujore prej 100 Euro vazhdon të jetë e njëjtë prej një dekade, duke mos marrë në konsideratë nevojat dhe inflacionin e lartë në vitet e fundit. Në kuadër të skemës së mbështetjes për persona me aftësi të kufizuara paraplegjikë dhe tetraplegjikë përfituan 711 fëmijë, ndërsa në kuadër të skemës së mbështetjes për persona të verbër përfituan 124 fëmijë.

Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre janë në gjendje shumë të rëndë sa i përket mbështetjes financiare dhe marrjes së shërbimeve të nevojshme. Duhet theksuar që për një pjesë të konsiderueshme të fëmijëve, njëri nga prindërit, e kryesisht nënat janë të detyruara të lënë punën për tu përkushtuar 24 orë për kujdesin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në këto raste, kemi ulje të të hyrave mujore në familje, që nënkupton uljen e mirëqenies ekonomike dhe sociale të familjes.³⁶ Po ashtu, duke pas parasysh natyrën e paqëndrueshme të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara të ofruara nga organizatat jo qeveritare, si pasojë e mos financimit të qëndrueshëm nga shteti i Kosovës, prindërit janë të detyruar të marrin këto shërbime edhe nga sektori privat, që nënkupton shpenzime më të mëdha për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe varfërim të familjeve të tyre.

³³ Të dhënat nga Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, 2023

³⁴ Ligji për Përkrahje Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme

³⁵ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

³⁶ Të dhënat nga organizatat anëtare Autizmi, Down Syndrome Kosova, Handikos, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA

Të dhënat për fëmijët përfitues nga skema e mbështetjes së familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara për vitin 2023

Muaji	Numri i fëmijëve përfitues
Janar	2,894
Shkurt	2,869
Mars	3,088
Prill	3,054
Maj	3,034
Qershor	3,228
Korrik	3,228
Gusht	3,205
Shtator	3,190
Tetor	3,333
Nëntor	3,323
Dhjetor	3,303

URGJENCA PËR MIRATIMIN E LEGJISLACIONIT GJITHËPËRFSHIRËS PËR MBËSHTETJEN E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Iniciativa për hartimin e një ligji gjithëpërfshirës e ndërmarrë në vitin 2018 me qëllim të mbështetjes të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara shënoi një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të legjislacionit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim u hartua Projektligji për të Drejtat, Vlerësimin, Trajtimin dhe Njohjen e Statusit, Shërbimet dhe Përfitimet për Personat me Aftësi të Kufizuara. Përveç tjerash, ky projektligj synon të ndryshojë qasjen e vlerësimit dhe trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke kaluar në modelin bio psiko social bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit, i njohur si ICF.


Megjithatë, me gjithë avokimin e shoqërisë civile për miratimin e këtij projektligji, ky projektligj është zvarritur tej mase prej gjashtë vitesh dhe nuk ka arritur akoma të miratohet. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të dëshmojë përkushtimin për fëmijët me aftësi të kufizuara përmes miratimit me urgjencë të këtij ligji, duke pasur parasysh gjendjen e rëndë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës.

SHËRBIMET SOCIALE PËR FËMIJËT



MESATARJA E RASTEVE PËR NJË ZYRTAR NË QENDRA PËR PUNË SOCIALE ISHTE RRETH 250 RASTE NË VIT

Shërbimet sociale ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale, ofruesit e tjerë publik si dhe organizatat joqeveritare të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Në territorin e Kosovës janë 38 Qendra për Punë Sociale në 38 komuna. Qendrat për Punë Sociale nuk kishin burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për ofrimin e shërbimeve sociale, ishin të mbingarkuara me reagim në raste emergjente, duke lënë mënjanë shërbimet parandaluese dhe shërbimet reintegruese. Ngarkesa e lartë e rasteve në raport me zyrtarët e shërbimeve sociale ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023, sidomos në komunat më të mëdha, ku mesatarja e rasteve për një zyrtar ishte rreth 250 raste në vit. Qendrat për Punë Sociale kanë vazhduar të punojnë në kushte të vështira infrastrukturore, ku vetëm 28% e Qendrave për Punë Sociale kishin kushtet infrastrukturore relativisht të mira, përderisa pjesa tjetër e Qendrave për Punë Sociale ofrojnë shërbimet në hapësira të papërshtatshme fizike.³⁷



VETËM

28%

E QENDRAVE PËR PUNË SOCIALE KANË KUSHTET INFRASTRUKTURE RELATIVISHT TË MIRA

Sfida të mëdha janë paraqitur në funksionimin e Organit të Kujdestarisë në kuadër të Qendrave për Punë Sociale. Për shkak të mungesës së stafit dhe profileve të profesionistëve në Qendra për Punë Sociale, veçanërisht të psikologëve dhe punëtorëve social, në shumë prej Qendrave për Punë Sociale është e pamundur funksionimi i Organit të Kujdestarisë sipas

kërkesave të Ligjit të Familjes.³⁸ Po ashtu, ka një moskuptim dhe keqkuptim esencial të Organit të Kujdestarisë dhe mënyrës së organizimit të këtij organi brenda Qendrave për Punë Sociale, gjë që reflektohet negativisht në mbrojtjen e të drejtave të kategorive të caktuara të klientëve në nevojë.³⁹

50 organizata joqeveritare të licencuara kanë ofruar shërbime të specializuara gjatë 2023 për kategori të ndryshme të fëmijëve.⁴⁰ Shërbimet e ofruara përfshijnë shërbimet rezidenciale për fëmijët viktime të dhunës në familje, abuzimit, neglizhimit dhe trafikimit, shërbimet e specializuara ditore për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, shërbimet në mbështetje të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbimet për fuqizimin e familjes dhe parandalimin e braktisjes së fëmijëve, mbështetjen e të rinjve, shërbimet për fëmijët përdorues të substancave narkotike, dhe shërbimet për fëmijët në situatë ruge dhe fëmijët e përfshirë në punë të rënda.

Sfidë kryesore e ofruesve të shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar mbetet financimi i paqëndrueshëm për ofrimin e shërbimeve sociale nga Ministria e Drejtësisë dhe komunat. Ministria dhe komunat nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar. Mbështetja ndaj organizatave joqeveritare është ofruar në baza ad hoc përmes subvencionimit edhe gjatë vitit 2023. Shuma e ndarë për ofrimin e shërbimeve nga organizatat joqeveritare ka qenë e pamjaftueshme dhe ka mbuluar një pjesë të vogël të kostos së përgjithshme të shërbimeve. Buxheti kryesisht është ndarë proporcionalisht në shumë të barabarta në mes të ofruesve të shërbimeve pa marrë parasysh nevojat e përfituesve.⁴¹

Megjithëse viti 2023 ishte vit më i favorshëm për ofruesit e shërbimeve sociale sa i përket financimit krahasuar me vitet paraprake, paralajmërimet për mbylljen e shërbimeve filluan në Nëntor 2023, duke qenë se në Dhjetor 2023, për pjesën dërrmuese të ofruesve të shërbimeve nga sektori jo qeveritar, po përfundonin projektet e donatorëve ndërkombëtarë në mbështetje të shërbimeve sociale, duke lënë zbrazëtira të mëdha në financimin e shërbimeve sociale. Duhet të theksohet që shërbimet sociale për fëmijët në masë të madhe vazhdojnë të mbesin në varësi të financimit nga organizatat ndërkombëtare.

Komunat të cilat kanë përgjegjësinë e plotë në sigurimin, menaxhimin dhe financimin e shërbimeve sociale për fëmijët dhe qytetarët e komunës, edhe pas 15 viteve që shërbimet sociale kanë kaluar nën përgjegjësinë e komunave, komunat nuk kanë vullnetin dhe gadishmërinë të sigurojnë dhe

³⁷ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, KOMF dhe Ministria e Drejtësisë, 2023

³⁸ Të dhënat nga Asosacioni i Qendrave për Punë Sociale, 2023

³⁹ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, KOMF dhe Ministria e Drejtësisë, 2023

⁴⁰ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁴¹ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF ofruese të shërbimeve sociale, 2023

financojnë në mënyrë të qëndrueshme shërbimet sociale për fëmijët. Përfundimisht, bëjnë një numër i vogël i komunave, sikurse Komuna e Prishtinës e cila ka ofruar mbështetje më të madhe krahasuar me komunat e tjera.

Shërbimet rezidenciale dhe shërbimet ditore për fëmijët financohen pjesërisht nga Ministria Drejtësisë përmes thirrjeve publike çdo vit. Nga viti 2016, ka pasur zbrazëtira kohore mes thirrjeve/kontratave për mbështetje të këtyre shërbimeve duke lënë pa përkrahje financiare këto shërbime çdo fillim vit. Mbështetja financiare nga Ministria e Drejtësisë ishte 1.5 milionë për rreth 50 organizata joqeveritare për periudhën Prill 2023 deri në Dhjetor 2024.⁴² Konkretisht, sipas të dhënave të organizatave anëtare të KOMF, mbështetja e marrë nga Ministria e Drejtësisë, mesatarisht mbulon me rreth 66% shërbimet rezidenciale dhe me rreth 21% shërbimet sociale ditore.⁴³



STREHIMORJA E VETME PËR FËMIJËT NË NIVEL NACIONAL U MBYLL NË MUNGESË TË FINANCIIMIT

Strehimorja e vetme për fëmijët në nivel nacional u mbyll në janar 2024 në mungesë të financimit.

Rreth 30 ofrues të shërbimeve nga sektori jo qeveritar, përfshirë shërbimet rezidenciale për viktimat, shërbimet ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në situatë rruge, fëmijët përdorues të drogave, kanë reduktuar shërbimet dhe rrezikojnë të mbyllën.

Për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm nga institucionet publike, në Janar 2024 u mbyll strehimorja e vetme në nivel nacional për fëmijët viktimat të dhunës në familje, abuzimit, trafikimit dhe neglizhimit.⁴⁴ Përderisa, pjesa dërmuese e ofruesve të shërbimeve reduktuan shërbimet dhe numrin e fëmijëve përfitues. Nëse kjo situatë vazhdon, do të krijohet kolaps në mbrojtje të fëmijëve dhe një situatë e pa precedent në Kosovë. Ndër çështjet prioritare që duhet të ndërhyjë shteti i

Kosovës është zhvillimi i një skeme të qëndrueshme për blerjen e shërbimeve nga sektori jo qeveritar.⁴⁵

Progres nuk kishte në hartimin e formulës së financimit për shërbime sociale dhe miratimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal me qëllim të krijimit të Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale. Procesi i kostimit dhe hartimit të formulës së financimit edhe pse i nisur pesë vite më parë, nuk arriti të finalizohet.⁴⁶ Po ashtu, nuk ka pasur një hartëzim të shërbimeve dhe nevojave të popullatës për shërbime që do të informonte edhe politikëbërjen komunale dhe qendrore në hartimin e programeve dhe planifikimin e shërbimeve konform nevojave.⁴⁷

Progres gjatë vitit 2023 kishte në avancimin e legjisllacionit për shërbime sociale. Hap i rëndësishëm ishte miratimi i Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, proces ky i nisur prej pesë vitesh, nga i cili pritet të zhvillohet reforma e shërbimeve sociale. Nga ky ligj derivojnë 22 udhëzime administrative të cilat do të mundësojnë zbatimin e ligjit.⁴⁸

Proces shumë i rëndësishëm konsiderohet hartimi i Udhëzimit Administrativ për kontraktimin e shërbimeve sociale nga organizatat jo qeveritare, pjesë e të cilit do të jenë edhe kostot për njësi për secilin shërbim social. Hartimi i kostove për njësi për shërbime social do të jetë parakusht për zhvillimin e procedurave për kontraktimin dhe blerjen e shërbimeve sociale nga sektori jo qeveritar, duke ndikuar në ndarje më të drejtë të financimit për shërbime sociale dhe rritjen e qëndrueshmërisë së shërbimeve.

Komunat nuk kanë instrumentet dhe kapacitetet e nevojshme për monitorim të shërbimeve sociale. Proceset e strukturuar të menaxhimit të të dhënave kanë vazhduar të mos jenë tërësisht funksionale. Qasje në këtë bazë të të dhënave kanë vetëm Qendrat për Punë Sociale, nuk përfshihen edhe të dhënat për përfituesit nga ofruesit jo qeveritarë dhe privatë të shërbimeve sociale.⁴⁹

Progres kishte sa i përket ngritjes së kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale. Programi i trajnimeve i akredituar në kuadër të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, u kompletua me 24 module për shërbime sociale.⁵⁰ 312 ofrues të shërbimeve sociale, prej të cilëve 174 nga sektori publik dhe 139 nga organizatat jo qeveritare, kanë rritur kapacitetet për ofrim të shërbimeve sociale cilësore për fëmijët dhe familjet e cenuara.

⁴² Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁴³ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF ofruese të shërbimeve sociale, 2023

⁴⁴ Njoftimi nga strehimorja Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët, 2023

⁴⁵ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF ofruese të shërbimeve sociale, 2023

⁴⁶ Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2023

⁴⁷ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, KOMF dhe Ministria e Drejtësisë, 2023

⁴⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

⁴⁹ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, KOMF dhe Ministria e Drejtësisë, 2023

⁵⁰ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

Rekomandime:

- ▶▶ Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve, fuqizimin ekonomik të tyre dhe përmirësimin e mirëqenies sociale;
- ▶▶ Miratimi i Ligjit të ri për Asistencë Sociale, largimi i kriterëve diskriminues për fëmijët. Rritja e shumës mujore të asistencës sociale për të përballuar inflacionin e ndodhur në vitet e fundit;
- ▶▶ Sigurimi i qëndrueshmërisë së shtesave për fëmijë përmes hartimit të bazës ligjore për shtesat për fëmijë; Reformimi i shtesave për fëmijë, përfshirja e moshës 17 deri 18 vjeç në kuadër të shtesave për fëmijë dhe rritja e shumës mujore; Rregullimi i përfitimit të shtesave për fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijët e marginalizuar;
- ▶▶ Integrimi apo ndërlidhja e shërbimit të asistencës sociale me shërbimet sociale dhe familjare, zyrat për punësim, shërbimet shëndetësore dhe ato arsimore;
- ▶▶ Miratimi i Projektligjit për të Drejtat, Vlerësimin, Trajtimin dhe Njohjen e Statusit, Shërbimet dhe Përfitimet për Personat me Aftësi të Kufizuar;
- ▶▶ Hartimi dhe miratimi i 22 Udhëzimeve Administrative që burojnë nga Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- ▶▶ Zhvillimi i standardeve minimale strukturore dhe funksionale për secilin shërbim social bazuar në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- ▶▶ Promovimi i Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare drejt komunave dhe ofruesve të shërbimeve sociale për të bërë të njohur reformën dhe risitë që sjell ky ligj;
- ▶▶ Identifikimi i nevojave aktuale në secilën komunë, përcaktimi i shërbimeve sociale të cilat mund të ofrohen nga Qendra për Punë Sociale. Shërbimet të cilat nuk mund të ofrohen nga Qendra për Punë Sociale duhet të paraqiten në planin vjetor për blerje të atyre shërbimeve nga sektori joqeveritar;
- ▶▶ Ridizajnimi i thirrjeve publike për mbështetjen e shërbimeve sociale, rregullimi i kontraktimit të shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori joqeveritar. Ministria dhe komunat duhet të rrisin pragun e financimit për shërbime sociale, të eliminonjë zbrazëtitë kohore në mes të thirrjeve, të financojnë shërbimet për periudha tre vjeçare si dhe të lidhin kontrata me organizatat e licencuara;
- ▶▶ Plotësimi dhe miratimi i standardeve minimale për secilin shërbim social; Krijimi i standardeve minimale nga Ministria për përcaktimin e ngarkesës së stafit dhe numrit mesatar të rasteve;
- ▶▶ Nxjerrja e kostove për njësi për secilin shërbim social, si parakusht për zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar;
- ▶▶ Miratimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal për krijimin e grantit të veçantë për shërbimet sociale dhe familjare. Ky grant do të duhet të përmbajë kriteret e qarta në mënyrë që të sigurojë ndarje të drejtë dhe financim adekuat për shërbimet sociale;
- ▶▶ Rritja e numrit të zyrtarëve për shërbime sociale në kuadër të Qendrave për Punë Sociale, sidomos të atyre me profil të “punëtorit social” dhe “psikologut”, për të përballuar ngarkesën e lëndëve si dhe për të mundësuar funksionimin e Organit të Kujdestarisë;
- ▶▶ Përmirësimi i kushteve të punës të Qendrave për Punë Sociale, sigurimi i hapësirave dhe pajisjeve të nevojshme. Sigurimi i qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në objektet e Qendrave për Punë Sociale;
- ▶▶ Krijimi i një baze të të dhënave të digjitalizuar dhe integruar në kuadër të Qendrave për Punë Sociale, ku do të përfshihen të dhënat edhe për përfituesit nga ofruesit joqeveritarë dhe privatë;
- ▶▶ Krijimi i sistemit të monitorimit nga komunat për monitorimin e shërbimeve sociale;
- ▶▶ Rritja e numrit të zyrtarëve për inspektimin e ofruesve të shërbimeve sociale publik, joqeveritar dhe atyre privat.



MBROJTJA E FËMIJËVE

MBROJTJA E FËMIJËVE

Nota: 2.52

- ▶ Mungesë e programeve për mbështetjen e prindërve, për të rritur fëmijët pa dhunë
- ▶ Mungesë e shërbimeve parandaluese dhe shërbimeve reintegruese për fëmijët
- ▶ Identifikim, raportim dhe vetë raportim i ulët i fëmijëve në situata të dhunës
- ▶ Sistem i fragmentuar i mbrojtjes së fëmijëve



634

fëmijë pa kujdes prindëror

555

fëmijë pa kujdes prindëror tek farefisi

79

fëmijë pa kujdes prindëror në familje strehuese

10

adoptime të realizuara, ndër të cilët nëntë vendorë dhe një ndërkombëtar

FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR

Gjatë vitit 2023 janë raportuar gjithsej 634 fëmijë pa kujdes prindëror.⁵¹ Krahasuar me vitin 2022 në të cilin 579 fëmijë ishin pa kujdes prindëror, ka një rritje me 55 fëmijë apo 9.5% të fëmijëve pa kujdes prindëror të vendosur në kujdestari. Ndërkohë që numri i fëmijëve të braktisur vazhdon të jetë në rënie pasi në vitin 2023 rezultojnë 10 fëmijë të braktisur krahasuar me 12 fëmijë të braktisur në vitin paraprak. Numri i fëmijëve të strehuar në strehim familjar tek farefisi gjatë vitit 2023 ishte 555 fëmijë, ndërkohë që numri i fëmijëve të strehuar në strehim familjar jashtë farefisit apo në familje strehuese gjatë të njëjtit vit, ishte 79 fëmijë.⁵²

Në vitin 2023, janë aprovuar 10 kërkesa për adoptim, prej tyre nëntë fëmijë janë adoptuar brenda vendit (adoptim vendor), dhe një fëmijë jashtë vendit (adoptim ndërkombëtar). Ndërkohë që nga 10 fëmijët e braktisur, tre prej tyre të lindur gjatë vitit 2023, janë ribashkuar me familjen biologjike.⁵³

Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror shënon rritje krahasuar me vitin paraprak. 634 fëmijë apo 9.5% më shumë se vitin e kaluar.

Numri i familjeve strehuese gjatë 2023 ishte 37 familje.⁵⁴ Vlen të theksohet se numri i familjeve strehuese përgjatë viteve të fundit është në rënie, duke vënë në rrezik këtë formë të mbrojtjes nëse i referohemi në të njëjtën kohë edhe shifrave në rritje të fëmijëve pa kujdes prindëror të cilët kanë nevojë për strehim. Institucionet duhet të bëjnë përpjekje imediate për të mirëmbajtur këta ofrues të shërbimeve, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e këtij mekanizmi thelbësor, si një nga format themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare për fëmijët pa kujdes prindëror. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare parasheh familjet strehuese si ofrues të shërbimeve sociale, prandaj duhet të procedohet me urgjencë në nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin e strehimit familjar, njohjen e statusit të familjeve strehuese si ofrues të shërbimeve dhe licencimin e tyre. Krahas licencimit, Ligji për Shërbime Sociale parasheh kompensimin e familjeve strehuese si ofrues të shërbimeve për fëmijët pa

⁵¹ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁵² Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁵³ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁵⁴ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

kujdes prindëror, prandaj duhet të ndryshohet edhe skema e kontraktimit dhe kompensimit për familjet strehuese. Aktualisht familjet strehuese kompensohen për shpenzimet mujore të ushqimit dhe veshmbathjes të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe nuk kompensohen për ofrimin e shërbimeve të strehimit.⁵⁵

KOMF ka adresuar në vazhdimësi sfidat të lidhura me strehimin familjar në Kosovë. Sfidë e madhe mbetet mungesa e familjeve strehuese në të gjitha komunat e Kosovës, sikurse parashihet në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, sipas të cilit çdo komunë duhet të ketë së paku tri familje strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të vlerësuara, trajnuara dhe të aprovuara sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale. Me gjithë bazën ligjore, familjet strehuese mungojnë në një pjesë të komunave, ato janë në vetëm 17 komuna, duke vështirësuar në këtë mënyrë gjetjen e zgjidhjes së menjëhershme për strehim të fëmijës. Vlen të potencohet që edhe komuna të mëdha sikurse Komuna e Pejës, Komuna e Mitrovicës, Komuna e Podujevës, Kamenica, Komuna e Klinës, etj, nuk kanë asnjë familje strehuese, përkundër që kanë në vazhdimësi raste të fëmijëve në nevojë për strehim.⁵⁶ Prandaj, është e domosdoshme hartimi i planeve të veprimit në secilën komunë për rritjen e vetëdijësimit strehimin familjar me qëllim rekrutimin e familjeve të reja strehuese.

Sfidë mbetet edhe mungesa e specializimit të familjeve strehuese aktuale, për të punuar me kategori të veçanta të fëmijëve. Konkretisht, problematikë e theksuar ka qenë mungesa e familjeve strehuese të specializuara për strehimin e fëmijëve në konflikt me ligjin nën moshën e përgjegjësisë penale (nën 14 vjeç) dhe strehimin e fëmijëve viktimë të trafikimit gjatë procesit të reintegrimit afatgjatë.⁵⁷ Është shumë e rëndësishme miratimi i Udhëzimit Administrativ për rregullimin e strehimit familjar i cili pritet të bëjë profilizimin e familjeve strehuese bazuar në nevojat e fëmijëve si dhe mbështetjen e fëmijëve në strehim familjar edhe pas moshës 18 vjeçare, përkatësisht deri në moshën 26 vjeçare sipas vlerësimit të Organit të Kujdestarisë.

Veç strehimit familjar, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2020, parasheh një formë të re të mbrojtjes për fëmijët pa kujdes prindëror, jetesën e pavarur e mbikëqyrur. Kjo e fundit është inkorporuar edhe në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare i cili është aprovuar në Dhjetor 2023.

Ligji i ri e njeh të drejtën e mbrojtjes së fëmijës pa kujdes prindëror edhe pas moshës 18 vjeç, konkretisht deri në moshën 26 vjeç, megjithatë ai ende nuk ka nisur të aplikohet pasi pritet aprovimi i Udhëzimit Administrativ për rregullimin e strehimit familjar. Gjatë vitit 2023, ka vijuar praktika e mëparshme, ku me arritjen e moshës 18 vjeçare, institucionet kanë ndërprerë shërbimet dhe kujdesin e ofruar, për të cilat fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë deri sa të fuqizohen dhe pavarësohen plotësisht.⁵⁸

Udhëzimi Administrativ që rregullon jetesën e pavarur të mbikëqyrur, i cili derivon nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, duhet të aprovohet sa më parë për të funksionalizuar formën e mbrojtjes jetesa e pavarur e mbikëqyrur, për fëmijët pa kujdes prindëror pas moshës 18 vjeç.

Shërbimet parandaluese të cilat duhet të ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale sipas mandatit të tyre, vazhdojnë të mos gjejnë zbatim. Këto shërbime kryesisht vazhdojnë të ofrohen nga sektori joqeveritar i cili në të njëjtën kohë vazhdon të ofrojë edhe pjesën dërrmuese të shërbimeve të tjera si mbrojtja, rehabilitimi, reintegrimi, fuqizimi e pavarësimi.⁵⁹

Arsyeja e mungesës pothuajse totale të shërbimeve të parandalimit të cilat synojnë uljen e rreziqeve për dëme të fëmijës, janë mungesa e burimeve të nevojshme në dispozicion të Qendrave për Punë Sociale, siç është mungesa e punëtorëve socialë të cilët aktualisht punojnë të mbingarkuar me raste, mungesa e burimeve të nevojshme financiare dhe e aseteve të domosdoshme për të ofruar këto shërbime.⁶⁰ Duke qenë se Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare ka kategorizuar shërbimet në tri kategori, shërbimet parësore, shërbime dytësore dhe shërbime tretësore, shteti i Kosovës duhet të investojë sidomos në shërbimet parësore të cilat janë kryesisht shërbime parandaluese, shërbime për fuqizimin e familjes, parandalimin e ndarjes së fëmijëve nga prindërit, përfshirë prindërimin e mirë.

Sfidë tjetër paraqet mos dhënia e mundësisë për adoptim për fëmijët pa kujdes prindëror mbi moshën 3 vjeçare të vendosur në strehim familjar apo rezidencial për një kohë shumë të gjatë dhe nuk konsiderohen për adoptim. Kosova është ndër vendet e vetme në Europën Juglindore me numrin më të vogël të rasteve të adoptimit të fëmijëve

⁵⁵ Të dhënat nga familjet strehuese dhe Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, 2023

⁵⁶ Të dhënat nga Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, 2023

⁵⁷ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF, 2023

⁵⁸ Të dhënat nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, 2023

⁵⁹ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF, 2023

⁶⁰ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, KOMF dhe Ministria e Drejtësisë, 2023

mbi moshën 3 vjeç për numër të popullsisë. Po ashtu, rol në mungesën e adoptimit të kësaj grupmoshe luan dhe hezitimi i vetë familjeve potenciale adoptuese për shkak të kërkesave të tyre për të adoptuar fëmijë nën moshën 3 vjeçare.

Gjatë vitit 2023, ka vazhduar ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve për fëmijët pa kujdes prindëror bazuar në programin standard të strehimit familjar si dhe bazuar në programin ndërkombëtar PRIDE, i dedikuar për ngritjen e kapaciteteve për familjet strehuese, për trajnim të familjeve potenciale strehuese dhe prindërve potencial adoptues.⁶¹

FËMIJËT E PËRFSHIRË NË PUNË TË RËNDA

Në Kosovë, nuk dihet numri i saktë i fëmijëve të përfshirë në punë të rënda. Duke pas parasysh listën e gjatë të punëve të rrezikshme të fëmijëve, institucionet nuk kanë kapacitetet në arritjen e të gjitha zonave për të bërë identifikimin e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda.

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar mungesa e shërbimeve të specializuara të ofruara nga komunat për të identifikuar dhe ofruar shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda. Mungojnë qendrat e kujdesit ditor dhe nuk ofrohet asnjë shërbim mbështetës social, arsimor e psikologjik për këta fëmijë. Ekipet mobile tashmë të funksionalizuara në disa komuna, të cilët shërbejnë për identifikimin e hershëm dhe reagimin ndaj rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë të rënda, kanë mungesë të dukshme të kapaciteteve për të identifikuar dhe raportuar rastet në kohë. Në të njëjtën kohë mungojnë plotësisht mekanizmat efikas për të bërë identifikimin e hershëm të rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe për tu mundësuar atyre marrjen e shërbimeve të nevojshme.⁶²



130

FËMIJË AKTIV JANË IDENTIFIKUAR NË SITUATË RRUGE NË 8 REGJIONE TË KOSOVËS

Fëmijët që kërkojnë lëmshë në situatë rruge janë ndër fëmijët më të cenueshëm të përfshirë në punë të rënda. Në total, në situatë rruge janë identifikuar 130 fëmijë aktiv në 8 regjione të Kosovës. Pothuajse 90% e fëmijëve në situatë rruge i përkasin komuniteteve etnike, si romë, ashkalinjë dhe egjiptianë.⁶³ Kjo tregon se diskriminimi strukturor dhe marginalizimi janë faktorë që rrisin cenueshmërinë e tyre. Fëmijët në situatë rruge në shumicën e rasteve kanë raportuar se varfëria ka qenë shkak kryesor që ata janë përfshirë në rrugë.⁶⁴ Gjatë 2023, nuk ka pasur strategji apo veprime nga institucionet publike për të adresuar këtë problematikë në mënyrë të qëndrueshme. Ekziston një nevojë urgjente për të hartuar dhe zbatuar një strategji të unifikuar kombëtare për çështjen e fëmijëve në situatë rruge, që trajton si parandalimin e fëmijëve dhe prindërve që të përfshihen në rrugë, ashtu edhe ndërhyrjen kur fëmijët gjenden në situatë rruge.



EDHE NË VITIN 2023 MBETEN VETËM DY QENDRA TË SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT E PËRFSHIRË NË PUNË TË RËNDA, NË PRISHTINË DHE PRIZREN

Dy qendrat e vetme ditore për trajtimin dhe reintegrimin e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda janë themeluar dhe drejtohen nga organizata Terre des hommes, e cila raporton se gjatë vitit 2023, ka ofruar shërbime për 124 fëmijë në Qendrën Ditore në Prishtinë dhe për 43 fëmijë në Qendrën Ditore në Prizren.⁶⁵

⁶¹ Të dhënat nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë dhe Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, 2023

⁶² Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF, 2023

⁶³ Studimi i Fëmijëve në Situata Rruge në Kosovë, UNICEF Kosovë 2023

⁶⁴ Studimi i Fëmijëve në Situata Rruge në Kosovë, UNICEF Kosovë, 2023

⁶⁵ Të dhënat nga raporti i Terre des hommes, 2023

TRAFIKIMI I FËMIJËVE

Gjatë vitit 2023 janë identifikuar gjithsej 17 viktima të trafikimit, prej të cilëve gjashtë ishin fëmijë. Krahasuar me vitin 2022, ka një rënie të ndjeshme të numrit të viktimave të trafikimit. Ashtu sikurse në vitin 2023, format kryesore të trafikimit me qenie njerëzore ishin shfrytëzimi seksual dhe puna e detyruar.⁶⁶ Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, vazhdojnë të jenë grup më i cenuar ndaj lypjes së detyruar, ku shpesh personat që i keqpërdorin janë prindërit ose të afërmit e tyre.

Shteti i Kosovës nuk i përmbush plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit, por ka bërë përpjekje në këtë drejtim. Shteti i Kosovës rriti përpjekjet e përgjithshme në parandalim, duke përfshirë rritjen e fondeve për fushatat ndërgjegjësuese dhe shtypjen e manualeve për mësuesit për parandalimin e trafikimit të fëmijëve. Drejtoria e Trafikimit të Qenieve Njerëzore kreu më shumë veprime dhe krijoi pamflete për të informuar viktimat për të drejtat e tyre dhe shërbimet e disponueshme.

Qendrat për Punë Sociale kanë vazhduar me ofrimin e shërbimeve për viktima të trafikimit. Megjithatë si pasojë e mungesës së burimeve të nevojshme, këto shërbime nuk

kanë qenë të plota dhe programet reintegruese që synojnë reintegrimin afatgjatë të këtyre fëmijëve, nuk kanë qenë efektive. Edhe identifikimi i hershëm i fëmijëve viktima të trafikimit vazhdon të jetë sfidë dhe në këtë drejtim ka nevojë të punohet në fuqizim të mekanizmave që nxisin raportimin dhe vetë-raportimin.

Qendrat për Punë Sociale duhet të kenë burimet e nevojshme në dispozicion për të ofruar shërbime cilësore dhe efektive.

Gjatë 2023, lypja e detyruar e fëmijëve nga prindërit, vazhdoi të klasifikohej si neglizhencë ose abuzim, dhe jo si trafikim. Për pasojë, besohet se në disa raste autoritetet kanë deportuar disa viktima të paidentifikuara trafikimi pa i referuar ato si raste potenciale të trafikimit, për të marrë shërbimet e nevojshme.

Është e rëndësishme të punohet në vazhdimësi për përmirësimin e koordinimit institucional në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Prandaj, është i nevojshëm monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë (2022-2026) dhe Planit të Veprimit (2022-2024).

⁶⁶Të dhënat nga Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikimin me Qenie Njerëzore; TIP Report, 2023

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS

Neni 38 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, ndalon ndëshkimin trupor dhe masat disiplinore, të cilat dëmtojnë dhe dobësojnë dinjitetin njerëzor të fëmijës, duke përfshirë format e dhunës fizike dhe mendore, si dhe sjelljet që e degradojnë, turpërojnë dhe e vënë fëmijën në situatë të dobët, në secilin ambient në shtëpi dhe familje, në institucione edukativo arsimore, në institucionet e kujdesit, organet e rendit dhe sistemit të drejtësisë, në ambientet e punës dhe komunitetit.⁶⁷ I njëjti nen, obligon ministritë përkatëse të krijojnë programe ndërgjegjësuere në lidhje me efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor dhe të hartojnë programe prindërimi që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe institucione edukativo arsimore dhe në institucione të kujdesit.

Megjithatë, edhe në 2023 në Kosovë nuk janë zhvilluar programe prindërimi për të siguruar mbështetjen e nevojshme për prindërit, për të rritur fëmijët e tyre pa dhunë. Po ashtu, nuk janë zhvilluar veprime apo aktivitete nga institucionet për mbështetjen e prindërve për mirërritjen e fëmijëve.

Ndërkohë Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, në Nenin 54, ka paraparë themelimin e shërbimeve parandaluese dhe hapjen e këshillimoreve familjare në secilën komunë, të cilat ndër të tjera ofrojnë shërbime në fushën psiko-sociale për familjet, me fokus të veçantë në ngritjen dhe forcimin e marrëdhënieve familjare.⁶⁸

Është e domosdoshme që të fillohet sa më parë themelimi dhe funksionimi i këtyre këshillimoreve familjare si formë shërbimit parandalues ndaj familjeve në nevojë për shërbime psiko-sociale, në mënyrë që të reduktohet rreziku dhe dëmi që mund ti shkaktohet fëmijëve në këto familje.

Gjatë vitit 2023, Policia e Kosovës ka raportuar gjithsej 106 raste të fëmijëve viktime të dhunës në familje.⁶⁹ Megjithatë, duke u nisur nga shifrat e larta të raportimeve në vitet e kaluara, nuk është ende e qartë nëse ka rënie të dukurisë së dhunës në familje apo nëse është ulur numri i raportimeve të dhunës në familje. Një observim i mëtejshëm është i nevojshëm nga institucionet për të siguruar se rastet dhe episodet e dhunës në familje raportohen dhe në të njëjtën

⁶⁷ Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁶⁸ Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare

⁶⁹ Të dhënat nga raporti i Policisë së Kosovës, 2023

⁷⁰ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2023

⁷¹ Të dhënat nga raporti i Policisë së Kosovës, 2023

kohë për të reduktuar hezitimet e mundshme të raportimit të dhunës në familje. Po ashtu, është e domosdoshme që të vijohet me fushatat e vetëdijesimit për të nxitur raportimin dhe vetë raportimin për rastet e dhunës në familje.



106

RASTE TË FËMIJËVE VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE NË 2023

Gjatë vitit 2023, strehimoret për mbrojtjen nga dhuna të drejtuara nga sektori joqeveritar kanë ofruar shërbime për 621 raste të viktimeve të dhunës në familje, prej të cilëve 286 gra dhe 335 fëmijë.⁷⁰ Shërbimet kryesore të ofruar nga këto strehimore kanë qenë shërbime të rehabilitimit për viktimat e dhunës. Megjithatë, strehimoret janë ballafaquar me sfida të theksuara të qëndrueshmërisë financiare, si pasojë e mungesës së financimit të qëndrueshëm dhe të nevojshëm për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve cilësore. Për pasojë, në janar 2024 është bërë mbyllja përfundimtare e strehimores së vetme nacionale për mbrojtjen e fëmijëve viktime të dhunës dhe abuzimit. Prandaj është e domosdoshme të rritet mbështetja financiare për strehimoret e drejtuara nga OJQ-të, për të ofruar ndihmën e nevojshme për viktimat.

Udhëzimi administrativ për themelimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili derivon nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, është miratuar. Megjithatë ende nuk ka nisur implementimi i tij dhe ende nuk ka nisur themelimi i këtyre shtëpive.

Akti nënligjor që përcakton rregullat dhe procedurat për mbajtjen e bazës së të dhënave me ADN-të e personave të dënuar për veprat penale kundër integritetit seksual, i cili buron prej Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, ende nuk është miratuar.

Dhuna në shkolla vazhdon të mbetet një fenomen tejet shqetësues i cili sikurse vitin paraprak ka shënuar një numër të lartë të rasteve të incidenteve të raportuara. Gjatë vitit 2023, Policia e Kosovës, ka raportuar gjithsej për 564 raste të incidenteve të ndodhur në shkolla dhe përreth tyre.⁷¹




564

**RASTE TË INCIDENTEVE
NË SHKOLLA
DHE PËRRETH TYRE**

VETËM 45

**RASTE TË DHUNËS
NË SHKOLLA TË
RAPORTUARA NË VITIN
SHKOLLOR 2022 – 2023**



VETËM

148

**PSIKOLOGË DHE 77 PEDAGOGË, TË PUNËSUAR NË
1,044 INSTITUCIONE ARSIMORE**

Ndërkaq, të dhënat e raportuara në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim – SMIA, vazhdojnë të mbeten shumë të ulëta dhe rastet e dhunës vazhdojnë të mos raportohen. Konkretisht, në vitin shkollor 2022 – 2023 kanë qenë gjithsej 45 raste të raportuara dhe në vitin shkollor 2023 – 2024 janë vetëm 27 raste të dhunës të raportuara në sistemin SMIA.⁷²

Arsyet e mungesës së raportimit janë të ngjashme me ato të viteve paraprake ku kryesisht shkollat kanë një tendencë për t'i mbajtur të fshehura dhe të izoluar rastet e dhunës në mënyrë që të ruajnë një imazh pozitiv të shkollës. Këto të dhëna të ofruara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dëshmojnë se jo të gjitha rastet e dhunës raportohen nga shkollat përkatëse, në sistemin SMIA. Për pasojë ka ende pikëpyetje mbi funksionimin adekuat dhe efektiv të sistemit të parandalimit dhe trajtimit të dhunës brenda shkollave, dhe zbatimit me sukses të Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar.

Mungesë e zbatimit efikas të Protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.

Problematikë mbetet mungesa e shërbimeve mbështetëse nga psikologët apo pedagogët. Për vitin 2023, kanë qenë vetëm 225 profesionistë mbështetës, konkretisht 148 psikologë dhe 77 pedagogë, të punësuar në 1,044 institucione arsimore. Nëse analizojmë raportin e numrit të fëmijëve me të cilët një profesionist punon, rezulton se një pedagog apo psikolog angazhohet me rreth 1,400 fëmijë duke qenë larg standardit të punës së një profesionisti me fëmijë, e që pamundëson në këtë rast, identifikimin e hershëm në kohë por edhe trajtimin e duhur të situatave të dhunës në shkolla.

Mekanizmat kryesorë për trajtimin e rasteve të dhunës në shkolla janë vetë organet dhe stafi i shkollës. Pas identifikimit dhe ndërhyrjes fillestare nga mësimmshënësit, sipas nevojës këto raste mund të referohen për shërbime të specializuara te pedagogu ose psikologu, apo edhe shërbime jashtë shkollës në nivel komunal.

Një mekanizëm i rëndësishëm i trajtimit të rasteve të dhunës në shkolla është programi i ndërmjetësimit mes moshatarëve. Nga viti 2015 deri në 2023, rreth 150 shkolla kanë marrë pjesë në trajnim dhe rreth 480 mësimmshënës janë certifikuar përmes këtij programi trajnimi. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të vazhdojë angazhimi në këtë drejtim, përmes përfshirjes së të gjitha shkollave në trajnim dhe certifikimit të mësuesve, në mënyrë që ndërmjetësimi mes moshatarëve të aplikohet në të gjitha shkollat.⁷³ Udhëzuesi për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve, i cili synon të parandalojë përfshirjen e fëmijëve në vepra penale, duke mos lejuar dhunë e konflikte, dhe duke përmirësuar marrëdhëniet shoqërore brenda shkollës, u miratua nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Drejtësisë.

Vlen të përmendet që Ministria e Arsimit ka ndërmarrë veprime, duke organizuar trajnime për mësimmshënësit në tetë komuna të Kosovës, me fokus në edukimin seksual dhe parandalimin e dhunës seksuale përmes procesit mësimor. Po ashtu, Ministria e Arsimit ka zhvilluar një paketë modulare mbi mbrojtjen e fëmijëve, me përfshirjen e temave për parandalimin e ngacmimeve seksuale dhe ka hartuar një informator për stafin arsimor, i cili trajton zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.⁷⁴

Në Kosovë, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve vazhdon të jetë i fragmentuar. Për pasojë shërbimet në mes të sektorit të arsimit, mirëqenies dhe shëndetësisë nuk janë të integruara. Ndërhyrjet dhe shërbimet e institucioneve janë të izoluar, të pakoordinuara dhe nuk plotësojnë një ndërparimet bazë për trajtimin e dhunës, atë të qasjes multidisiplinare.

⁷² Të dhëna nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023
⁷³ Të dhëna nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023
⁷⁴ Të dhëna nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

Rekomandime:

- » Krijimi dhe fuqizimi i programeve dhe shërbimeve parandaluese për mbrojtjen e fëmijëve, prindërimin e mirë dhe fuqizimin e familjeve;
- » Themelimi i Këshillimoreve familjare në komuna ashtu sikurse parashihet në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, për ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për familjet, me fokus të veçantë në ngritjen dhe forcimin e marrëdhënieve familjare;
- » Zhvillimi i strehimit familjar pas moshës 18 vjeçare përmes zhvillimit të formës së re të mbrojtjes “Jetesa e pavarur e mbikëqyrtur”;
- » Rritja e numrit të familjeve strehuese dhe shtrirja e tyre në të gjitha komunat siç parashihet në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, së paku tre familje strehuese për një komunë;
- » Specializimi i familjeve strehuese sipas kategorive të fëmijëve dhe ngritja e kapaciteteve të familjeve strehuese dhe prindërve potencial adoptues;
- » Njohja e statusit të familjeve strehuese si ofrues të shërbimeve sociale, ashtu sikurse parashihet në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- » Themelimi dhe funksionalizimi i ekipeve mobile në të gjitha komunat për identifikim të fëmijëve në situatë rruge dhe fëmijëve të përfshirë në punë të rënda;
- » Zgjerimi i shërbimeve për fëmijët e përfshirë në punë të rënda, sigurimi i banimit sipas nevojës, ushqimit dhe veshmbathjes, sigurimi i shërbimeve sociale për fëmijët dhe prindërit e tyre;
- » Hapja e qendrave ditore të specializuara për fëmijët e përfshirë në punë të rënda;
- » Ofrimi i aftësisimit profesional dhe punësimi i prindërve të fëmijëve të përfshirë në punë të rënda;
- » Hartimi i planit të unifikuar nacional për fëmijët në situatë rruge;
- » Fuqizimi i mekanizmave për identifikim dhe raportim të rasteve të trafikimit;
- » Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për reintegrimin afatgjatë të fëmijëve që janë viktime të trafikimit;
- » Rregullimi i financimit të qëndrueshëm të strehimoreve që strehojnë dhe mbrojnë fëmijët viktime të trafikimit;
- » Zbatimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë (2022-2026) dhe Planit të Veprimit (2022-2024);
- » Themelimi dhe ofrimi i programeve dhe shërbimeve për prindërim të mirë, fuqizim të familjes dhe parandalim të dhunës në familje;
- » Realizimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e mësimeve dhe stafit arsimor në lidhje me parandalimin e dhunës dhe trajtimin e rasteve të saj;
- » Themelimi i linjës telefonike falas për mbrojtjen e fëmijës, i paraparë në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, për të rritur raportimin e rasteve të dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe trafikimit të fëmijëve;
- » Themelimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve;
- » Miratimi i aktit nënligjor që përcakton rregullat dhe procedurat për mbajtjen e bazës së të dhënave me ADN-të e personave të dënuar për veprat penale kundër integritetit seksual, i cili buron prej Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës;
- » Ndërhyrje dhe investim të menjëhershëm mes Ministrive për themelimin dhe fuqizimin e shërbimeve të integruara edukative, psikologjike dhe sociale, me qëllim parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve;
- » Rritja e inspektimit të ofruesve të shërbimeve, me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe rritjen e cilësisë.



SHËNDETI


SHËNDETI

Nota: 2.6

- ▶ Mungesë e theksuar e të dhënave në fushën e shëndetësisë
- ▶ Shpenzime të mëdha për qytetarët për shërbime shëndetësore
- ▶ Mungesë e shërbimeve të shëndetit mendor të fëmijëve



31,110
lindje



Shkalla e mbulueshmërisë me
vaksinat është **92%**

124
RASTE

të vdekjes së foshnjave

Edhe në vitin 2023, është evidentuar mungesë e theksuar e të dhënave në fushën e shëndetësisë. Të dhënat për nivelin e gjidhënies, numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, numrin e fëmijëve përdorues të drogave, etj, shërbimet shëndetësore të ofruara nga sektori privat, nuk ishin të disponueshme. Mos funksionalizimi i Sistemit të Informacionit Shëndetësor vështirëson në masë të madhe grumbullimin e të dhënave për informimin shëndetësor dhe planifikimin e ndërhyrjeve bazuar në të dhëna. Prandaj, është i domosdoshëm funksionalizimi i Sistemit të Informacionit Shëndetësor për të realizuar mbledhjen e të dhënave të sakta për shëndetin e fëmijëve dhe nevojat.

Aktualisht nuk ka të dhëna të disponueshme nga institucionet publike për kënaqshmërinë e pacientëve me shërbimet shëndetësore, përkatësisht kënaqshmërinë me shërbimet shëndetësore për fëmijët. Institucionet publike nuk realizojnë hulumtime dhe monitorim për matjen e kënaqshmërisë së pacientëve me shërbime shëndetësore.

Për tu vlerësuar është fakti që buxheti për shëndetësi ka pasur rritje të konsiderueshme në vitin 2023, ku nga 198 milionë Euro sa ishte në vitin 2022, për vitin 2023 janë ndarë 296 milionë Euro.⁷⁵

Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk kanë qasje të mjaftueshme në kujdesin shëndetësor për shkak të pagesave të larta për ilaçe, nga xhepi i tyre. Kjo është akoma më problematike, duke patur parasysh që 22% e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri, përdërisa 7% prej tyre, jetojnë në varfëri ekstreme. Sipas Anketës së Treguesve të Shumëfishtë MICS të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, përqindja e fëmijëve e mbuluar nga ndonjë sigurim shëndetësor ishte 5.6% për fëmijët nën 5 vjeç dhe 3.6% për fëmijët mbi 5 vjeç. Gjatë katër viteve të fundit është punuar në hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurime Shëndetësore, por ky projektligj është shtyrë vit pas viti në agjendën legjislative dhe nuk është miratuar.

⁷⁵Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2023


VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE

Në vitin 2023, janë regjistruar gjithsej 31,110 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës), prej tyre vetëm në Kosovë janë 21,654, nga të cilat meshkuj 11,207 apo 51.8% dhe 10,447 apo 48.2% lindje janë femra.⁷⁶ Krahasuar me të dhënat e vitit 2022, konstatohet një rënie e lindjeve në Kosovë.⁷⁷

Foshnje të vdekura në vitin 2023, të ndodhura vetëm në Kosovë ishin 124. Vdekshmëria e foshnjave dhe fëmijëve në Kosovë është trefishi i mesatares së Bashkimit Evropian, dhe më e larta në rajon.⁷⁸

Ndër shkaktarët e vdekjeve të foshnjave në Kosovë janë shkaqet perinatale, prematuriteti me komplikime, anomalitë, komplekse të lindura dhe infeksionet. Pavarësisht kësaj, përgjithësisht faktorët që ndikojnë në vdekshmërinë e lartë të foshnjave dhe fëmijëve në Kosovë ndikohen prej mungesave në sistemin shëndetësor, që nga diagnostikimi deri te mungesa e kapaciteteve për t'i trajtuar shkaqet. Foshnjat dhe fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë hasin në barriera më të mëdha në qasje në shërbimet shëndetësore.

Në institucionet shëndetësore në Kosovë mungon diagnostikimi i hershëm dhe i plotë i foshnjave pas lindjes. Në vendet me sistem të zhvilluar shëndetësor, foshnjave qysh pas lindjes iu bëhet testi i skriningut, i cili mundëson diagnostikimin e gjendjes shëndetësore. Kjo përfshin analizat e gjakut për sëmundje e çrregullime të ndryshme të trashëgueshme, dëgjimin dhe problemet me zemër. Programi Nacional për Skrining Neonatal është buxhetuar me 140,000 euro për dy vitet e ardhshme. Ky program përbën një prej veprimeve, që synojnë uljen e sëmundjeve dhe vdekshmërisë së foshnjave sipas Planit Strategjik për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe Shëndetin Riprodhues.⁷⁹



42, 369

VIZITA MJEKËSORE PËR NËNA DHE FËMIJË

⁷⁶ Të dhënat nga Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës, përkatësisht Zyrat e Gjendjeve Civile, 2023

⁷⁷ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2023

⁷⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023

⁷⁹ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

⁸⁰ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

⁸¹ Të dhënat nga Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, 2023

Gjatë 2023, janë realizuar 42,369 vizita mjekësore për nëna dhe fëmijë.⁸⁰ Parashihet që një fëmije të porsalindur deri në moshën tre-vjeçare ti bëhen pesë vizita të rregullta. Por jo të gjithë fëmijët e kanë marrë këtë shërbim. Gjendja është më e rëndë kur është fjala për qasje në shërbime mjekësore e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptian. Fëmijët nga komunitetet vazhdojnë të vuajnë nga shëndeti i dobët për shkak të qasjes së kufizuar në shërbimet shëndetësore, varfërisë dhe pamundësisë për të paguar për trajtimin dhe blerjen e barnave, si dhe mungesa e personelit mjekësor dhe ekipeve mobile, etj.

GJIDHËNIA

UNICEF dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandojnë që foshnjat duhet të ushqehen me gji brenda orës së parë të lindjes dhe të ushqehen vetëm me gji gjatë 6 muajve të parë të jetës. Në katër vitet e fundit, nuk ka të dhëna zyrtare të publikuara apo të disponueshme për shkallën e gjidhënies në Kosovë.



E TË PORSALINDURVE USHQEHEN ME GJI BRENDA ORËS SË PARË PAS LINDJES

Sipas raportit MICS të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe UNICEF 2020, 32% e të porsalindurve ushqehen me gji brenda orës së parë pas lindjes, ndërsa të ushqyerit vetëm me gji është prevalent vetëm për 29% të fëmijëve nën moshën 6 muajsh. Kjo nënkupton që shumë nëna në Kosovë nuk e fillojnë të ushqyerit me gji mjaftueshëm herët, apo nuk i ushqejnë fëmijët e tyre vetëm (ekskluzivisht) me gji për 6 muajt e rekomanduar apo ndalojnë të ushqyerit me gji shumë herët. Vlen të përmendet që sipas MICS, shkalla e ushqyerjes me qumësht gjiri është në rënie, krahasuar me rezultatet e MICS të vitit 2017.

Klasat për Nëna dhe Fëmijë në kuadër të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare në 18 komuna dhe në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike në Prishtinë kanë vazhduar mbështetjen e nënave përmes edukimit shëndetësor të nënave nga para-lindja deri tek procesi i pas-lindjes dhe kujdesit për fëmijën, duke ndikuar në zhvillimin në fëmijërinë e hershme.⁸¹

IMUNIZIMI

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, gjatë viteve të fundit si pasojë e Covid – 19, është regjistruar rënie e shkallës së imunizimit të rregullt në nivel global. Kjo rënie është evidentuar edhe në Kosovë dhe raportohet që ende Kosova nuk është në shkallën e mbulueshmërisë me vaksina të rregullta në nivelin para Covid -19.⁸²

Duke marrë parasysh barrën serioze të shëndetit publik të kancerit të qafës së mitrës, sëmundjeve invazive pneumokokale dhe diarreve rotavirus, si dhe disponueshmërinë e vaksinave të sigurta dhe efektive, në Prill 2023, Ministri i Shëndetësisë miratoi rekomandimet e Komitetit Profesional Këshillues për Imunizim (KPKI) për përfshirjen e tri vaksinave të reja dhe përditësimin e Kalendarit të rregullt të vaksinimit: Vaksinën kundër pneumokokut (PCV); Vaksinën kundër rotavirusit (Rotarix) dhe Vaksinën kundër human papilloma virus (HPV).⁸³

Krahasuar me vitin 2022, ka pasur rritje të mbulueshmërisë në vaksinim rreth 2% (DTP1, 95 %, MMR1, 92%). Ndërsa sa i përket DTP2 dhe DTP3, fëmijët nuk kanë arritur të përfundojnë serinë e vaksinave brenda vitit kalendarik 2023 për arsye se diferenca nga doza në dozë bazuar në Kalendarin e ri të vaksinimit është dy muaj, rrjedhimisht këta fëmijë janë bartur në vitin 2024 për të vazhduar vaksinimin me dozat e radhës.

Sa i përket vaksinimit me vaksinën kundër pneumokokut dhe rotavirusit nga muaji tetor deri me 31 dhjetor është raportuar numër i njëjtë me vaksinat që jepen në të njëjtën kohë dhe nuk ka pasur as më të voglin hezitim nga prindërit për ti vaksinuar fëmijët me këto vaksina shitesë. Për vitin shkollor 2022/2023 janë planifikuar: klasa e I-rë 23,921, ndërsa janë vaksinuar (bOPV,DT,MMR) 22631 apo 95%, në nivel vendi. Klasa e VI-të në total janë planifikuar 24,016, kurse janë vaksinuar (bOPV, dT) 22659 apo 94%.⁸⁴

Gjatë vitit 2023 janë raportuar gjithsej 232 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 13.01/100 000 banorë), prej tyre 161 raste me Meningjit viral, 65 raste me Meningjit bakterial dhe me Meningoencephalitis TBC 6 raste. Ky numër i rasteve të raportuara paraqet një rritje prej 1.1 herë më të lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 ku janë raportuan 112 raste. Sa i përket grup-moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup moshës 0-9 vjeç me 40.9% (95 raste), grup moshat 10-19 vjeç me 23.7% (55 raste).

⁸² Të dhënat nga Raporti i Institutit të Shëndetësisë Publike në Kosovë, 2023

⁸³ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

⁸⁴ Të dhënat nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, 2023

⁸⁵ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

⁸⁶ Të dhënat nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, 2023

FURNIZIMI ME BARNA NGA LISTA E BARNAVE ESENCIALE

Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 60 milionë Euro për listën e barnave për 2023, që është më shumë se dyfish rritje e buxhetit sidomos krahasuar vitin paraprak.⁸⁵ Megjithatë, në vazhdimësi gjatë vitit 2023 ka pasur mungesë të barnave dhe materialit shpenzues në Klinikat e Qendrës Klinike universitare të Kosovës. Madje është raportuar se në disa klinika mungojnë edhe penjtë për operacion. Po ashtu, edhe Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare kanë vazhduar të përballesh me mungesën e barnave esenciale. Është raportuar që nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare mungojnë pjesa më e madhe e barnave nga Lista esenciale si dhe se pacientët që marrin trajtim në këto qendra, duhet që vet t'i blejnë barnat dhe materialet për të marrë një injeksion apo infuzion, pasi që këto u mungojnë këtyre qendrave. Mungesa e terapisë së nevojshme për fëmijët në nevojë për terapinë përkatëse, mund të sjellë pasoja për shëndetin e fëmijëve. Sa i përket mungesës së barnave, në mungesë të tyre, prindërit detyrohen t'i blejnë nga xhepi i tyre barnat nga lista esenciale.

Sa i përket furnizimit me barna nga Lista Esenciale në kujdesin parësor shëndetësor, në vitin 2022 mesatarja e furnizimit me barna nga lista esenciale ishte 45%, ndërsa mesatarja e furnizimit me material shpenzues për vitin 2022 ishte 71.71%.⁸⁶ Megjithatë, edhe pse është raportuar në vazhdimësi për mungesën e barnave në nivelin parësor, për vitin 2023, nuk ka të dhëna të disponueshme për nivelin e furnizimit.

Gjatë 2023, Klinika e Neonatologjisë për herë të parë bëri kërkesë emergjente për furnizim me medikamentin surfakant, pa të cilin foshnjat e lindura para kohe mund të vdesin. Furnizimi me këtë medikament u bë nga Ministria e Shëndetësisë. Prej vitesh tashmë, medikamentin surfakant e siguronte organizata anëtare e KOMF, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë për Klinikën e Neonatologjisë. Mirëpo, kishte raste të caktuara, ku klinika mbetej e pambuluar me furnizim me këtë medikament, duke rrezikuar seriozisht jetët e foshnjave të lindura para kohe. Poashtu, është për tu vlerësuar që ky medikament është përfshirë në kuadër të Listës së Barnave Esenciale.

KUJDESI SPITALOR NË KLINIKËN E PEDIATRISË NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS - QKUK

Bazuar në të dhënat nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Klinika e Pediatriisë ka raportuar se në vitin 2023 numri i fëmijëve të hospitalizuar ishte 7141 fëmijë. Shërbimet shëndetësore të ofruara ishin 21,256 vizita specialiste dhe 35,540 vizita ambulatorie në emergjencë. Në këtë klinikë gjithsej janë 151 shtretër. Raportohet që në pjesën më të madhe të kohës ka mbingarkesë në Klinikën e Pediatriisë. Numri i stafit mjekësor në Klinikën e Pediatriisë është 47 mjekë, 136 infermierë, 1 psikolog klinik dhe dy punetore social. Ky numër i personelit është i pamjaftueshëm për të përmbushur të gjitha nevojat e fëmijëve në klinikën e Pediatriisë. Për shkak të kufizimeve në burime njerëzore, personeli shëndetësor është tejte i ngarkuar në ofrim të shërbimeve shëndetësore për fëmijët.

Funksionalizimi i spitalit të ri kirurgjik-pediatrik ka përmirësuar përkujdesin shëndetësor të fëmijëve në nivel terciar. Spitali ka integruar shërbimet e emergjencave pediatrike mjekësore, ato të traumës, shërbimet e rikuperimit, ambulancave specialiste, pediatrike dhe kirurgjike e të tjerë. Megjithatë duke parë mbingarkesën dhe numrin e vogël të stafit, rritja e burimeve njerëzore dhe riorganizimi i punës është i domosdoshëm. Poashtu është e nevojshme rregullimi i kuzhinës së qumështit me standarte evropiane.⁸⁷

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Aktualisht nuk ka të dhëna të disponueshme nga institucionet publike për kënaqshmërinë e pacientëve me shërbimet shëndetësore, përkatësisht kënaqshmërinë me shërbimet shëndetësore për fëmijët. Institucionet publike nuk realizojnë hulumtime dhe monitorim për matjen e kënaqshmërisë së pacientëve me shërbime shëndetësore. Por, sipas të dhënave të Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve, bazuar në hulumtimin e bërë në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit dhe Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit lidhur me matjen e kënaqshmërisë dhe eksperiencave të pacientëve, evidentohen shumë mangësi, e sidomos tek shërbimet shëndetësore për fëmijët.

Të dhënat tregojnë së 66 % e pacientëve në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit janë ndarë të kënaqur me

shërbimet shëndetësore, 26% nuk kanë qenë të kënaqur dhe 8% kanë qenë mesatarisht të kënaqur. Pacientët e Repartit të Pediatriisë, radhiten ndër repartet që kanë treguar nivel më të ulët të kënaqshmërisë krahasuar me pacientët e reparteve të tjera. Në këtë rezultat kanë ndikuar shumë faktorë sikurse qasja, shërbimet mjekësore, infermierore, diagnostike, kushtet infrastrukturore dhe higjiena, furnizimi me barna, cilësia e ushqimit, etj. Për nevoja të këtij raporti vlen të përmendet që të dhënat po ashtu tregojnë për nivel të ulët të higjienës tek Reparti i Pediatriisë krahasuar me repartet e tjera. Rreth 41% e të anketuarve kanë deklaruar që një pjesë të barnave për trajtim të sëmundjes i kanë blerë dhe 32% e të anketuarve kanë deklaruar që të gjitha barnat i kanë blerë në barnatore private. Sa i përket gjendjes së shtretërve, Reparti i Pediatriisë është vlerësuar me gjendje mesatare. Shkalla e njohurive të pacientëve për të drejtat e tyre në kujdes shëndetësor është e ulët. Personeli shëndetësor në 95% të rasteve nuk i njofton pacientët për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.⁸⁸

Ndërsa, sa i përket nivelit të kënaqshmërisë së pacientëve në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, të dhënat tregojnë për një kënaqshmeri nën mesatare, ku 42% e pacientëve nuk ishin të kënaqur me shërbimet shëndetësore, 40% kanë qenë të kënaqur dhe 18% kanë qenë mesatarisht të kënaqur. Shkalla e njohurive të pacientëve për të drejtat e tyre në kujdes shëndetësor është e ulët. Personeli shëndetësor në 98% të rasteve nuk i njofton pacientët për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.⁸⁹

Linja e ankesave funksionon në Ministrinë e Shëndetësisë në kuadër të Divizionit për të Drejtat e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor. Në vitin 2023 numri i ankesave të pranuar dhe adresuar ishte 214 ankesa, ky numër vlen për ankesat që kanë plotësuar kriteret për procedimin e mëtutjeshëm, pa përfshirë thirrjet e qytetarëve që i janë drejtuar linjës për informacione, këshilla dhe duke shprehur shqetësime të ndryshme lidhur marrjen e shërbimeve shëndetësore, licencimin e profesionistëve shëndetësor, licencimin e Institucione private shëndetësor, trajtim shëndetësor jashtë vendit etj. Numri më i madh i ankesave është drejtuar ndaj kujdesit dytësor shëndetësor, duke pasuar më pas me kujdesin parësor, institucionet e kujdesit shëndetësor privat dhe kujdesit shëndetësor tretësor. Ankesat e drejtuara në linjë ishin si në vijim: Mungesë stafi në vend punë 38 ankesa; Sjellje jo etike profesionale e stafit shëndetësor 71 ankesa; Mungesë e barërave 12 ankesa; Të ndryshme 93 ankesa. Ndërsa, masat u ndërmorën vetëm për 5 raste, masë ndëshkuese me gjobë për dy raste; Ndalim i ngritjes në detyrë për një rast dhe Vërejtje me gojë për dy raste.⁹⁰

⁸⁷ Të dhënat nga Klinika e Pediatriisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, 2023

⁸⁸ Të dhënat nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK, 2023

⁸⁹ Të dhënat nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK, 2023

⁹⁰ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

RREGULLIMI I STATUSIT TË ORGANIZATAVE JO QEVERITARE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PËR FËMIJËT

Prej më shumë se 20 vitesh, pjesa dërrmuese e shërbimeve për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara ofrohen nga organizatat joqeveritare, pa pagesë, e të mbështetura kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë. Këto shërbime ofrohen në kuadër të qendrave ditore të specializuara dhe të menaxhuara nga organizatat joqeveritare, të cilat në baza ditore ofrojnë për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, shërbime rehabilituese të profilit shëndetësor sikurse fizioterapi, ergoterapi, logopedi, seanca psikologjike individuale dhe grupore, etj.⁹¹ Në anën tjetër, një mori e shërbimeve shëndetësore ofrohen nga organizatat jo qeveritare për fëmijët dhe të rriturit përdorues të substancave narkotike, fëmijët në situatë rruge, fëmijët nga komunitetet e marginalizuara, etj. Këto shërbime ofrohen nga organizatat jo qeveritare me një përvojë të gjatë, infrastrukturë të përshtatshme dhe nga profesionistë të kualifikuar në fushën e shëndetësisë.⁹²

Vlerësohet se rreth 50 organizata jo qeveritare ofrojnë shërbime të integruara të profilit shëndetësor dhe social. Megjithatë këto organizata nuk janë të licencuara si ofrues të shërbimeve shëndetësore, për shkak të supozimeve për mangësi ligjore në kuadër të Ligjit për Shëndetësi. Brenda Ligjit për Shëndetësi vlerësohet të ketë dispozita

kontradiktore, rreth ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga organizatat jo qeveritare dhe licencimit të tyre. Neni 15, paragrafi 2, i Ligjit për Shëndetësi përcakton që “Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen nga institucionet shëndetësore publike, private dhe publiko-private”. Përderisa, Neni 38 “Institucionet shëndetësore në kuadër të shoqërisë civile”, përcakton që “Shërbimet e kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësore humanitare dhe në format e tjera të organizimit të shoqërisë civile në lëminë e shëndetësisë, rregullohen me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria”. Vlen të përmendet që ky akt nënligjor nuk është nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe deri tani asnjë organizatë jo qeveritare nuk është e licencuar për ofrim të shërbimeve shëndetësore.

Neni 15 dhe Neni 38 vlerësohen të kenë krijuar konfuzion dhe pasiguri juridike tek zbatuesit e ligjit. Kjo situatë po dëmton statusin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shëndetësore të ofruara në kuadër të organizatave jo qeveritare, madje mund të cilësohet edhe si diskriminuese për sektorin jo qeveritar. Nuk janë të pakta rastet, kur organizatat jo qeveritare krahas statusit të organizatës jo qeveritare, janë detyruar të licencohen si institucione private për të mundësuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore, megjithëse të gjitha shërbimet e ofruara janë pa pagesë.⁹³

Rregullimi i statusit të OJQ-ve si ofrues të shërbimeve shëndetësore do të rrisë qasjen në kujdesin e specializuar për popullatën e cënueshme dhe do të ndikojë në rritjen e qëndrueshmërisë së shërbimeve dhe rritjen e llogaridhënies.

⁹¹ Të dhënat nga organizatat anëtare në KOMF, 2023

⁹² Të dhënat nga organizatat anëtare në KOMF, 2023

⁹³ Të dhënat nga organizatat anëtare në KOMF, 2023

PËRDORIMI I SUBSTANCAVE NARKOTIKE NGA FËMIJËT

Përdorimi i substancave narkotike nga fëmijët përbën një ndër problematikat më të mëdha në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Jashtëzakonisht shqetësuese mbetet fakti që mosha mesatare e fillimit të përdorimit të drogave është në rënie, ku nga 18 vjeç në vitin 2018, në 16 vjeç në periudhën e fundit. Përderisa institucionet publike nuk kanë të dhëna në nivel nacional për numrin e fëmijëve dhe personave përdorues të substancave narkotike, sipas Labyrinth, vlerësohet se numri i përgjithshëm i përdoruesve ka kaluar shifrën prej 30,000, ndërkohë që fëmijët dhe adoleshentët përdorues vazhdojnë të bëjnë pjesë çdo vit e më shumë në këtë shifër.⁹⁴



MOSHA MESATARE E FILLIMIT TË PËRDORIMIT TË DROGAVE ËSHTË NË RËNIE

Hapa pozitiv janë ndërmarrë rreth kornizës ligjore, ku gjatë vitit 2023 Qeveria miratoi Udhëzimin Administrativ Nr 05/2023 për masat për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2023 për trajtimin mjekësor dhe psikologjik, të fëmijës viktimë e abuzimit, për ti ndihmuar në rehabilitim dhe për t'u ri integruar në shoqëri.⁹⁵

Ngjashëm me vitin e kaluar, edhe në vitin 2023, marihuana ka vazhduar të jetë substanca më e përdorur në Kosovë. Përderisa deri në vitin 2018 ka pasur ulje të përdorimit të heroinës tek popullata e përgjithshme, gjatë katër viteve të fundit është vërejtur një rritje e lehtë e përdoruesve të heroinës në veçanti te komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa ka një rritje të shpejtë dhe shumë të madhe të përdorimit të kokainës te popullata e përgjithshme. Drogat stimulante si ekstazi, mdma, amfetamina, ghb, lsd, etj, janë të pranishme gjithashtu, por nuk ka ndonjë trend të dukshëm të rritjes së përdorimit apo qarkullimit të drogave të reja në treg (NPS - New Psychoactive Substances). Po ashtu, arsyet mbesin të njëjta, sikurse, disponueshmërinë e drogave në treg, traumën e fëmijërisë së hershme,

mungesën e informacionit mbi rreziqet e përdorimit të drogave, presionin shoqëror dhe kureshtjen për të provuar gjëra të reja, etj.⁹⁶

Progres nuk ka pasur në 2023 në sigurimin e shërbimeve dhe programeve të qëndrueshme parandaluese të cilat janë më se të nevojshme duke parë trendet në rritje të përdorimit të drogave nga fëmijët dhe adoleshentët. Përrjashtim bën Policia e Kosovës, e cila ka programin vjetor të ligjëratave në parandalim dhe vetëdijësim të dukurive, ku është e përfshirë edhe tema lidhur me parandalimin e substancave narkotike.

Është e domosdoshme që Qeveria të prioritizojë mbrojtjen e fëmijëve përdorues të substancave narkotike dhe të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të rritur ndërgjegjësimin, dhe të zhvillojë programe për parandalimin dhe trajtimin e abuzimit të drogave në Kosovë. Kosova nuk ofron mjaftueshëm shërbime të qasshme për identifikimin e fëmijëve që janë viktimë të abuzimit me narkotikë. Ka mungesë të shërbimeve dhe ekipeve mobile në komunitet që do të mundësonin testimin dhe identifikimin e rasteve të mundshme të fëmijëve që përdorin substancat narkotike.

Shteti i Kosovës nuk ofron shërbime të veçanta të rehabilitimit për fëmijët viktimë të abuzimit me narkotikë. Shërbimet ekzistuese ofrohen në kuadër të trajtimit të të rriturve që përdorin narkotikë. Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka improvizuar një repart të posaçëm për trajtimin e varësisë por ky repart është i dedikuar për pacientët e rritur, edhe pse ai trajton edhe fëmijët duke qenë se nuk ekziston asnjë objekt tjetër në dispozicion ose repart i veçantë për fëmijët. Kjo njësi nuk është e përshtatshme për fëmijët dhe nuk është mjedis miqësor dhe i sigurtë për ta. Trajtimi shëndetësor në QKUK bazohet në programet e detoksikimit ku përdoren barna nga Lista e Barnave Esenciale.

Profesionistët ndeshen me sfida të mëdha në trajtimin e fëmijëve që janë viktimë të abuzimit me droga. Ata nuk disponojnë burimet e nevojshme, duke përfshirë ekipe multidisiplinare, reparte të posaçme për fëmijë, për zbatimin e planeve dhe programeve të specializuara për rehabilitim. Profesionistët nuk kanë burimet e nevojshme për të mbështetur prindërit ose kujdestarët në trajtimin dhe mbështetjen e fëmijëve të tyre që janë viktimë të abuzimit me droga. Kjo mungesë e burimeve dhe shërbimeve bën që prindërit dhe kujdestarët të ndihen të papërgatitur në luftën kundër abuzimit me droga të fëmijëve të tyre

⁹⁴ Të dhënat nga Organizata Labyrinth, 2023

⁹⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2023

⁹⁶ Të dhënat nga Organizata Labyrinth, 2023

SHËNDETI MENDOR

Numri i kërkesave nga fëmijët për shërbime të shëndetit mendor është rritur, përderisa numri i profesionistëve të shëndetit mendor është tejet i kufizuar për të përballuar kërkesat dhe për ofruar shërbime cilësore.⁹⁷ Në kuadër të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë operojnë këto klinika: Klinika e Psikiatrisë në Shërbimin Spitalor Universitar i Kosovës, Reparti i Psikiatrisë i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, Reparti i Psikiatrisë i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, Reparti i Psikiatrisë i Spitalit të Përgjithshëm në Gjiilan, Reparti i Psikiatrisë në Prizren dhe Qendrat e Shëndetit Mendor në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj dhe Gjakovë. Sa i përket burimeve njerëzore, në nivel vendi në institucionet publike shëndetësore janë të punësuar 52 psikiatër, prej të cilëve 45 psikiatër për të rritur dhe vetëm 7 psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë në nivel të gjithë vendit. Po ashtu janë 10 specialistë të psikologjisë klinike, 2 psikologë klinik, 7 punëtorë social dhe 2 këshilltarë psikosocial, që zhvillojnë veprimtarinë në nivelin dytësor dhe tretësor shëndetësor, si dhe 217 infermierë.

Në kuadër të sektorit privat të shërbimeve shëndetësore, ekziston një numër i konsiderueshëm i shërbimeve psikiatrike dhe psikologjike, megjithatë nuk ka të dhëna për numrin e fëmijëve të trajtuar në shërbimet e sektorit privat.



**VETËM 10 SPECIALISTË TË PSIKOLOGJISË KLINIKE
DHE 2 PSIKOLOGË KLINIK NË NIVELIN DYTËSOR
DHE TRETËSOR SHËNDETËSOR**

PIRJA E DUHANIT, ALKOOLIT, PIJEVE ENERGJIKE, NARGJILEVE DHE CIGAREVE ELEKTRONIKE (VAPE)

Kosova vazhdon të mos ketë të dhëna për numrin e fëmijëve të cilët përdorin duhan, pije energjike dhe cigare elektronike. Ligji për Kontrollin e Duhanit, nuk po arrin të zbatohet, madje nuk respektohet as në lokalet pranë shkollave që frekuentohen rregullisht nga fëmijët. Konsumimi i pijeve energjike është një tjetër shqetësim i rëndësishëm për shëndetin e fëmijëve në Kosovë. Tregu i këtyre produkteve në Kosovë është shumë i gjerë dhe ato shiten kudo, pa marrë parasysh moshën e personit. Pijet energjike përmbajnë kafeinë dhe stimulues të zemrës, të cilat jo vetëm që nuk janë të nevojshme për fëmijët, por janë të dëmshme dhe mund të ndikojnë në ritmin e zemrës dhe të shkaktojnë probleme të tjera shëndetësore. Madje, nuk është finalizuar dhe aprovuar Projektligji për ndalimin e pijeve energjike për fëmijët, duke përfshirë edhe ato me sasi të lartë të sheqerit. Përkundër hapave të ndërmarrë në këtë drejtim, duke përfshirë formimin e një grupi punues nga Komisioni Parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për hartimin e këtij ligji, ende nuk ka arritur të përfundohet një draft ligji dhe të aprovohet.

Poashtu, ende nuk ka një bazë ligjore që rregullon konsumimin e nargjileve dhe cigareve elektronike, të njohura ndryshe si "vape". Deri tani, nuk janë ndërmarrë hapa për të rregulluar këtë çështje dhe ndaluar shitjen e këtyre produkteve tek fëmijët. Gjithashtu, është shqetësuese edhe mungesa e rregullimit ligjor në kuadër të Kodit Penal të Kosovës që ndëshkon shitjen dhe shërbimin e pijeve alkoolike për personat nën moshën 16 vjeç. Në legjislationin e Kosovës, fëmijët konsiderohen personat deri në moshën 18 vjeç, kështu që kjo bie ndesh me rregullimin ligjor që përcakton fëmijët në Kosovë si dhe privon mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve nga përdorimi i substancave të dëmshme.

⁹⁷ Të dhënat nga Qendrat e Shëndetit Mendor, 2022

Rekomandime

- ▶ Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave për gjidhënien, numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, shërbimet e ofruara për fëmijët në sektorin privat, numrin e fëmijëve viktimë të abuzimit me narkotikë, etj.;
- ▶ Zbatimi i skringut apo "screening test" tek të porsalindurit në institucionet publike dhe private shëndetësore për diagnostikim të hershëm të sëmundjeve potenciale;
- ▶ Fuqizimi i programit të vizitave shëndetësore në shtëpi në të gjitha komunat e Kosovës, për të mundësuar vaksinimin në shtëpi, mbështetjen e praktikave të gjidhënies, të ushqyerit e shëndetshëm si dhe identifikimin e problemeve shëndetësore tek fëmijët;
- ▶ Replikimi i modelit të Qendrave Informuese për Shëndetin e Gruas (Klasat për nëna) për edukimin shëndetësor, shëndetin e nënave gjatë shtatzënisë, gjidhënien, vaksinimin dhe rritjen e shëndetshme të fëmijëve;
- ▶ Realizimi i transportit neonatal nga spitalet rajonale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK si dhe ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për transportin neonatal;
- ▶ Edukimi shëndetësor për përmirësimin e praktikave shëndetësore, planifikim familjar, shëndetin riprodhues dhe marrjen e shërbimeve shëndetësore;
- ▶ Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me barna në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK, spitalet rajonale dhe kujdesin shëndetësor parësor, për të garantuar që barnat esenciale për fëmijët të mos mungojnë;
- ▶ Rregullimi ligjor për njohjen e statusit të organizatave jo qeveritare në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët;
- ▶ Nxjerrja e aktit nënligjor për licencimin e organizatave jo qeveritare për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët bazuar në Ligjin për Shëndetësi;
- ▶ Themelimi i shërbimeve dhe programeve për parandalimin e përdorimit të drogave nga fëmijët;
- ▶ Organizimi i ekipeve mobile në komunitet për identifikim, testim dhe mbështetje të rasteve të fëmijëve viktimë të abuzimit me droga;
- ▶ Themelimi i shërbimeve për fuqizimin e prindërve për të rritur kapacitetet e prindërve për kujdesin dhe mbështetjen e fëmijëve gjatë rehabilitimit dhe re integrimit;
- ▶ Rritja e burimeve njerëzore brenda institucioneve publike shëndetësore për shëndetin mendor, rritja e numrit të psikiatërve, psikologëve, logopedëve dhe punëtorëve social për fëmijë;
- ▶ Plotësim ndryshimi i Kodit Penal të Republikës së Kosovës për ndalimin e shitjes dhe konsumimit të alkoolit për personat nën moshën 18 vjeç;
- ▶ Miratimi i Projektligjit për ndalimin e shitjes dhe konsumimit të pijeve energjike të fëmijët;
- ▶ Rritja e monitorimit dhe inspektimit të pirjes së duhanit në të gjitha ambientet e ndaluara me ligj;
- ▶ Kontraktimi i organizatave jo qeveritare për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët, shërbime këto të cilat nuk ofrohen nga institucionet publike.



**ZHVILLIMI NË
FËMIJËRINË E HERSHME**

ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Nota: 2.5

- ▶ Përfshirje e ulët e fëmijëve në edukimin parashkollor, kapacitet i vogël i rrjetit të institucioneve parashkollore
- ▶ Mungesë e investimeve për zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme
- ▶ Pabarazi e theksuar në qasjen në shërbime në fëmijërinë e hershme
- ▶ Mungesë e programeve për identifikim dhe ndërhyrje në fëmijërinë e të hershme



Edhe pse vitet e fundit Qeveria e Kosovës ka vendosur Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme, si një nga prioritetet e saj kryesore, investimet për zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme mbeten ende të pamjaftueshme. Kosova vazhdon të ketë nivelin më të ulët të përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor krahasuar me shtetet tjera të rajonit. Arsytet kryesore për një pjesëmarrje kaq të ulët është kapaciteti i vogël absorbues i rrjetit të institucioneve parashkollore me kosto të përballueshme dhe vetëdija e përgjithshme për format tradicionale të edukimit brenda familjes.



VETËM

54

INSTITUCIONE PARASHKOLLORE/ÇERDHE NË SEKTORIN PUBLIK DHE 164 KOPSHTË PRIVATE TË LICENCUARA

Në nivel të Kosovës gjithsej janë 54 institucione parashkollore/çerdhe në sektorin publik. Institucionet parashkollore janë të fokusuar në zona urbane, përderisa 10 komuna nuk kanë asnjë institucion parashkollor publik. Zonat rurale janë pothuajse të përjashtuara nga qasja në shërbime për zhvillim në fëmijëri të hershme. Gjatë vitit

2023 ka përfunduar ndërtimi i çerdhes në Suharekë dhe në Prizren, po vazhdon ndërtimi i dymbëdhjetë çerdheve të reja të kontraktuara me investime nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe gjashtë të tjera me investime nga Bashkimi Europian me projektin IPA 2016, si dhe janë kontraktuar për ndërtim edhe gjashtë çerdhe të reja.




10

KOMUNA NUK KANË ASNJË INSTITUCION PARASHKOLLOR PUBLIK

Ndërsa, 164 kopshte private operojnë me licencë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.⁹⁸ Konsiderohet se një numër i madh i kopshteve private punojnë pa licencë dhe mungon sistemi i monitorimit dhe inspektimit të tyre. Institucionet e qëndrimit ditë kanë të përfshirë fëmijë të moshës para fillore, mirëpo inspektimi i bërë në baza periodike bëhet vetëm në kopshte. Po ashtu, nëse kopshtet janë të regjistruara si organizata joqeveritare atëherë ato nuk hyjnë nën fushëveprimin e inspektoratit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Kjo përbën një shqetësim të madh, sepse nënkupton që një pjesë e ofruesve të shërbimeve në fëmijërinë e hershme nuk kanë asnjë mbikëqyrje dhe llogaridhënie nga shteti.

⁹⁸Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

Në Kosovë, ka mungesë të programeve alternative për mbështetjen e prindërve, shërbime për ndërhyrje të hershme në ambient familjar, mungesë të qendrave ditore, qendrave mësimore, qendrave në komunitet, grupeve mbështetëse të prindërve, etj. Sipas Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2022 - 2026, Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër të përmirësojë qasjen dhe cilësinë e shërbimeve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme.⁹⁹ Aktualisht, vetëm 15% e fëmijëve të moshës 3 - 4 vjeç marrin pjesë në programe të edukimit të hershëm¹⁰⁰, shumica e të cilëve vijnë nga familje me gjendje ekonomike më të mirë. Statistikat tregojnë se shumë fëmijë në Kosovë mbeten të privuar nga të drejtat e tyre për zhvillim në fëmijërinë e hershme dhe përballen me diskriminim bazuar në aftësi të kufizuara, etni, status socio-ekonomik dhe vendbanim.¹⁰¹ Vetëm 1 në 3 fëmijë të moshës 2 - 4 vjeç përfitojnë nga stimulimi i hershëm i anëtarëve të rritur të familjes përmes aktivitete si tregimi i historive, këndimi, leximi ose lojëra të thjeshta.¹⁰²



E FËMIJËVE TË MOSHËS 3 - 4 VJEÇ MARRIN PJESË NË PROGRAME TË EDUKIMIT TË HERSHËM

Numri total i fëmijëve të përfshirë në arsimin parashkollor në vitin 2022 - 2023 është 32,397, ku 24,366 fëmijë janë të përfshirë në arsimin parashkollor publik, kurse 6,630 fëmijë në arsimin parashkollor privat. 5,420 fëmijë janë të përfshirë në institucionet parashkollore publike (0-4 vjeç), ndërsa 18,946 janë të përfshirë në arsimin parafillor publik (6 vjeç). Sa i përket institucioneve edukative-arsimore private të licencuara nga MASHTI, aktualisht në arsimin parashkollor (0 - 4 vjeç) janë të përfshirë 4,280 fëmijë dhe në arsimin parafillor (5 vjeç) janë të përfshirë 2,350 fëmijë.¹⁰³

Fëmijët që vijnë nga grupet e margjinalizuara edhe pse janë të liruar nga pagesa, shumë shpesh nuk përfshihen për shkak të kufizimit të numrit të fëmijëve. Vetëm 1 në

10 fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian e në mesin e atyre edhe ata nga zonat rurale vijojnë programe nga edukimi i hershëm. Nga total 24,366 fëmijë në arsimin parashkollor publik, vetëm 884 fëmijë i përkasin komuniteteve të tjera jo shumicë, ndërkaq 23,482 janë Shqiptarë. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve në arsimin parafillor, 95.8% e fëmijëve janë shqiptarë, ndërsa 4.2 % e fëmijëve i përkasin grupeve tjera etnike.¹⁰⁴ Kjo çështje është shqetësuese, pasi edukimi cilësor në fazat e hershme të jetës zvogëlon dallimet në zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijëve nga familjet në nevojë. Kufizimi i mundësive dhe mungesa e kërkesës për kujdes dhe edukim të hershëm do të thotë që shumë fëmijë nuk përfshihen në sistemin arsimor deri pak para fillimit të shkollës, duke shkakuar vonesa në zhvillimin e tyre social dhe edukativ. Për më tepër, gratë shpesh mbesin si kujdestare parësore të fëmijëve pa ndonjë mbështetje në ambientet familjare, si dhe jashtë tregut të punës.

Një zhvillim pozitiv në aspektin e kornizës ligjore ka qenë miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Ky ligj pritet të krijojë bazën ligjore për koordinimin ndërsektorial dhe të fillojë integrimin e shërbimeve në fëmijërinë e hershme ndërmjet sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Arsimit ka nisur hartimin e udhëzimeve administrative. Megjithatë, deri më tani, asnjë udhëzim administrativ nuk është miratuar.

Edukimi dhe kujdesi në vitet e hershme janë veçanërisht të rëndësishme për fëmijët e vegjël me aftësi të kufizuara, por ata përballen me pengesa të mëdha në qasjen e shërbimeve të nevojshme. Ka mungesë të programeve për identifikim dhe ndërhyrje në fëmijërinë e të hershme, e cila ndikon negativisht në zhvillimin e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Në vitin 2022 - 2023, 52 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës (1 - 6 vjeç) janë përfshirë në qendra burimore/shkolla speciale. 620 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës (1 - 6 vjeç) në total janë përfshirë në klasat e rregullta. Numri i vogël i shërbimeve që ekzistojnë ofrohen nga sektori joqeveritar, të cilët sfidë kryesore e kanë mos qëndrueshmërinë e shërbimeve. Këto shërbime funksionojnë të ndara mes sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Nuk ka koordinim apo integrim mes tyre, duke e detyruar familjen të kalojë nga një institucion

⁹⁹ Strategjia e Arsimit 2022-2026, <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/>

¹⁰⁰ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, <https://askapi.rks-gov.net/Cus-tom/08eb3166-e575-407aa383-d959ead4088e.pdf>

¹⁰¹ Mbështetja e Përmirësimit të Arsimit dhe Kujdesit Cilësor në Fëmijërinë e Hershme (ECEC), Grupi i Bankës Botërore, 2022

¹⁰² Anketa e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, <https://askapi.rks-gov.net/Cus-tom/08eb3166-e575-407aa383-d959ead4088e.pdf>

¹⁰³ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022-2023, <https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/07/Statistikat-e-arsimit-ne-Kosove-2022-2023.pdf>

¹⁰⁴ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022-2023, <https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/07/Statistikat-e-arsimit-ne-Kosove-2022-2023.pdf>

në tjetrin për të marrë shërbimet e nevojshme. Shërbimet janë kryesisht të fokusuar në trajtim dhe ka mungesë të shërbimeve parandaluese. Në Kosovë nuk mund të gjendet asnjë vlerësim i numrit të fëmijëve nga lindja deri në pesë vjet me situata të rrezikuara, vonesa zhvillimore dhe aftësi të kufizuara. Nuk është realizuar asnjë studim i popullsisë për të identifikuar shkallën e fëmijëve të vegjël me këto kushte.¹⁰⁵

Aktualisht, asnjë dokument i politikave nuk ofron bazë ligjore për shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, si dhe organizimin dhe koordinimin e tyre. Kornizat e tjera ekzistuese për shërbimet në fëmijëri të hershme mund të ndihmojnë në zhvillimin dhe/ose integrimin e politikave dhe mekanizmave specifike të ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme.¹⁰⁶

Zhvillimi i një sistemi të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në mbarë Kosovën është thelbësor për përmirësimin e jetës së të gjitha familjeve të fëmijëve nga lindja deri në moshën gjashtë vjeç me situata të rrezikuara, vonesa zhvillimore, aftësi të kufizuara, çrregullime të sjelljes dhe nevoja të shëndetit mendor.

Një nismë drejt ndërhyrjes dhe integritit të shërbimeve në fëmijërinë e hershme është modeli i vizitave sistematike në shtëpi, i cili realizohet nga profesionistët shëndetësor të kujdesit parësor në kuadër të Qendrave të Mjekësisë Familjare.¹⁰⁷

Shërbimet e Programit të Vizitave në Shtëpi, të krijuara në vitin 2013, tani kanë arritur mbulim në tërë Kosovën. Personeli i Qendrave të Mjekësisë Familjare ka marrë trajnime që janë bazuar në një model shëndetësor të komunitetit dhe jo në një model thjeshtë mjekësor. Për më tepër, të njëjtat

trajnime u ofrohen edukatorëve dhe ofruesve të shërbimeve sociale duke synuar të sigurojnë një lidhje më të mirë dhe ofrim të shërbimeve në mënyrë të integruar. Këto shërbime të Vizitave në Shtëpi fokusohen në zhvillimin e fëmijës duke përdorur një qasje holistike, duke përfshirë të ushqyerit, prindërimin e përgjegjshëm, përfshirjen e baballarëve, stimulimin dhe edukimin e hershëm, dhe deri në një farë mase, identifikimin e hershëm të vonesave zhvillimore. Ato mund të zhvillohen më tej për të kryer monitorimin e zhvillimit dhe ekzaminimet për identifikimin e hershëm të fëmijëve në situata të rrezikuara, vonesa zhvillimore, dhe me aftësi të kufizuara.

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm në fëmijërinë e hershme është edhe ushqyerja e shëndetshme. Një nismë e mirë lidhur me ushqyerjen ishte miratimi i Udhëzuesit për Planifikimin e Ushqyerjes në Institucionet Parashkollore në Republikën e Kosovës i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë.¹⁰⁸ Megjithëse planifikimi vlerësohet të jetë i mirë, ky udhëzues nuk po gjen zbatim.

Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme është hartuar përgjatë vitit 2023 dhe tashmë është në proces të pilotimit. Ministria e Arsimit ka filluar procesin e trajnimit të trajnerëve për pilotimin e Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, proces ky që pritet të realizohet në 10 komuna, 12 institucione parashkollore dhe 20 klasë parafillore.¹⁰⁹ Kurrikula e re sjell një perspektivë të reformuar për edukimin e hershëm, qasje gjithëpërfshirëse me fëmijën në qendër, duke pasur parasysh trendet zhvillimore në vend dhe në nivel ndërkombëtar.

¹⁰⁵ Analizë e Situatës së Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë, Universiteti i Psikologjisë, 2023

¹⁰⁶ Analizë e Situatës së Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë, Universiteti i Psikologjisë, 2023

¹⁰⁷ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2023

¹⁰⁸ https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Udhëzuesi-dhe-menute_July_2022_E-lektoruar-1.pdf?fs=e&s=cl

¹⁰⁹ <https://masht.rks-gov.net/mashti-ka-filluar-trajnimin-e-trajnerëve-per-pilotimin-e-kurrikulës-per-efh/>

Rekomandime:

- ▶▶ Aprovimi i Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme;
- ▶▶ Hartimi dhe aprovimi i udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme;
- ▶▶ Rritja e numrit të institucioneve parashkollore dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në nivelin parashkollor;
- ▶▶ Përfshirja më e madhe e fëmijëve të cenueshëm sikurse fëmijët më aftësi të kufizuara, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët që jetojnë në varfëri, fëmijët e komuniteteve, etj, në kuadër të institucioneve parashkollore;
- ▶▶ Zhvillimi i programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme sikurse programet për mbështetjen e prindërve, qendrat në komunitet, qendrat ditore, kujdesi për fëmijët në familje, ndërhyrja në fëmijërinë e hershme, grupet e prindërve, vizitat sistematike në shtëpi, ekipet mobile për fëmijëri të hershme, platformat online për fëmijëri të hershme;
- ▶▶ Avokimi dhe ndërgjegjësimi për sistemet e ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme, për të krijuar një kuptim të përbashkët mbi rëndësinë e tyre ndërmjet palëve të interesit dhe shoqërisë civile;
- ▶▶ Krijimi i bazës ligjore dhe procesit të planifikimit për sistemin e Ndërhyrjes së Fëmijërisë së Hershme në mbarë vendin;
- ▶▶ Krijimi i një sistemi referimi për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme dhe udhëzime që sigurojnë referime efektive, vlerësime zhvillimore dhe ekzaminime të rregullta për fëmijët;
- ▶▶ Realizimi i vizitave sistematike në shtëpi bashkë me profesionistët shëndetësor, arsimor dhe social për të bërë identifikim të hershëm, menaxhim të rasteve dhe ofrim të mbështetjes për prindërit dhe kujdestarët për zhvillimin në fëmijërinë e hershme;
- ▶▶ Rritja e shumës së subvencioneve për Qendrat Mësimore që ofrojnë mbështetje për fëmijët në nivelin parashkollor nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- ▶▶ Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në institucionet parashkollore si mjet kyç për të siguruar ambient të sigurtë dhe mbrojtës për fëmijët si dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për zbatimin e saj;
- ▶▶ Monitorimi i zbatimit të Udhëzuesit për Planifikimin e Ushqyerjes në Institucionet Parashkollore;
- ▶▶ Integrimi i shërbimeve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme mes sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale;
- ▶▶ Përmirësimi i vlerësimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve parashkollore;
- ▶▶ Krijimi i bazës ligjore dhe standardeve për qëndrime ditore të fëmijëve të moshës së arsimit para fillor të cilat operojnë ose ndaras ose në kuadër të kopshteve private;
- ▶▶ Ndërlidhja me Departamentin për organizata joqeveritare në kuadër të Ministrisë respektive (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal apo Ministria e Punëve të Brendshme) në rastet kur kopshtet private janë të regjistruara si organizata joqeveritare.



ARSIMI

ARSIMI

Nota: 2.33

- ▶ Cilësi e ulët e arsimit në Kosovë
- ▶ Mungesë e infrastrukturës në shkolla
- ▶ Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla nuk është kuptimplotë dhe e bazuar në nevojat individuale të fëmijëve
- ▶ Mungesë e stafit profesional dhe mbështetës sikurse psikologë, pedagogë dhe asistentë për fëmijë me aftësi të kufizuara në shkolla



Në arsimin parauniversitar janë gjithsej 300,362 nxënës (153,796 djem dhe 146,566 vajza). Në sistemin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët marrin pjesë 212,967 nxënës, ndërsa arsimin e mesëm të lartë e ndjekin 63,029 nxënës. Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2022-2023, numri i përgjithshëm i personelit arsimor është 27,747, prej të cilëve 22,893 janë mësimitdhënës, 1,592 janë staf administrativ dhe 3,262 janë staf ndihmës. Në Kosovë funksionojnë gjithsej 1,044 institucione publike edukative-arsimore.¹¹⁰ Sistemi arsimor parauniversitar përballlet me sfida dhe probleme të shumta, të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e përgjithshme të arsimit dhe reflektohen në rezultatet e dobëta të nxënësve si dhe në vlerësimet ndërkombëtare.



KALUESHMËRIA NË TESTIN E ARRITSHMËRISË PËR VITIN 2023 ISHTE VETËM 52.1%.¹¹¹

Ndërkaq, Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve "PISA" e ka renditur Kosovën në vendin e 76-të nga 80 vende pjesëmarrëse, duke shënuar rezultate të ulëta në cilësinë e arsimit. Nxënësit kosovarë kanë mbetur prapa krahasuar me mesataren e vendeve të OECD dhe të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Në krahasim me vitin 2018, ata kanë shënuar

rënie prej 11 pikësh në fushën e leximit dhe matematikës dhe 8 pikësh në shkencë.

Vështirësitë me të cilat përballlet sistemi arsimor në Kosovë përfshijnë mungesën e infrastrukturës adekuate shkollore, cilësinë e mësimitdhënës, cilësinë e teksteve shkollore, buxhetin e pamjaftueshëm për trajnime, materialet e papërshtatshme mësimore për planprogramin e ri dhe mungesën e mekanizmave për sigurimin e cilësisë. Po ashtu, qëndrimi i shkurtër në shkolla, numri tejet i madh i nxënësve në klasa, planprogrami i mbingarkuar, shkollat, klasat me numër shumë të vogël të nxënësve në fshatra, duke përfshirë edhe klasat e kombinuara, mungesa e aktiviteteve jashtëkurrikulare, menaxhimi i dobët i shkollave, politizimi i kuadrove arsimorë, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet prindërve, mësimitdhënësve dhe nxënësve, llogaridhënia e ulët dhe ndërprerjet e shpeshta të procesit mësimor (përfshirë grevat në arsim) janë gjithashtu çështje serioze që ndikojnë në sistemin arsimor.

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha për përmirësimin e infrastrukturës, Kosova ende nuk ka arritur standardet e nevojshme për qasjen në institucionet arsimore. Shkollat ende punojnë me ndërtime, mungojnë hapësira të mjaftueshme për nxënësit sipas standardeve ndërkombëtare dhe ka mungesë pajisjesh për laboratorë dhe punëtori.

Në anën tjetër, gjendja dhe cilësia e mësimit në shkollat e vogla dhe paralelet e ndara në Kosovë është shumë e rënduar, duke u karakterizuar nga mungesa e infrastrukturës, burimeve dhe personelit të kualifikuar. Shumë prej këtyre shkollave nuk i përmbushin kriteret minimale për cilësinë

¹¹⁰ Statistikat e arsimit në Kosovë 2022-2023, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimitne-kosove-2022-2023/>

¹¹¹ <https://masht.rks-gov.net/publikohen-rezultatet-e-testit-te-arritshmerise-arritshmeria-e-pergjithshme-52-1-perqind/>

e arsimit, dhe mësimi i kombinuar vazhdon të zbatohet. Ndërkohë, në nivel komunal nuk ka ekspertizë të nevojshme, as qasje sistematike e të planifikuara për t'u ballafaquar me problemin e shkollave të vogla dhe paraleleve të ndara. Zakonisht, qasja është fragmentare dhe intervenimet ndodhin vetëm në rastet kur ato bëhen të domosdoshme. Kryesisht, komunat tregojnë përkushtim, por edhe presin ndihmën e Ministrisë së Arsimit për trajtimin e çështjeve të rrjetit të shkollave dhe të shkollave para shuarjes, si shkak i rënies së numrit të nxënësve.¹¹²

Problematike mbetet edhe cilësia e teksteve shkollore. Lidhur me këtë, një hap pozitiv nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ishte iniciimi i rishikimit të teksteve të lëndës së gjuhës shqipe dhe matematikës nga klasa 1 – 9. Me mbështetjen e Bashkimit Europian, ka përfunduar faza e parë e rishikimit të teksteve të gjuhës shqipe dhe matematikës dhe është prezantuar raporti për 38 tekste shkollore. Po ashtu, Ministria e Arsimit ka deklaruar që janë në proces të fillimit të rishikimit të teksteve të shkencës.

Për të krijuar një sistem për parandalimin, reagimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, Ministria e Arsimit ka miratuar Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve. Kjo politikë është integruar në rregulloren për punësimin e drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe stafit të shkollave, rregullore e cila nuk është aprovuar ende. Ministria e Arsimit ka mbajtur seanca informuese nëpër komuna për të mobilizuar zbatimin e kësaj politike. Deri tani, këto seanca janë mbajtur në vetëm katër komuna. Janë zhvilluar gjithashtu punëtori me inspektorët e arsimit, por monitorimi pritet të fillojë pas përfundimit të seancave në të gjitha komunat. Shkollat ende nuk kanë caktuar një person përgjegjës për rastet e shkeljes së politikës të mbrojtjes së fëmijëve, por këto emërimet do të bëhen pas përfundimit të seancave dhe do të pasohen nga trajnime të mëtejshme.¹¹³

Ministria e Arsimit ka organizuar trajnime për mësimdhënësit në tetë komuna të Kosovës, me fokus në edukimin seksual dhe parandalimin e dhunës seksuale përmes procesit mësimor. Po ashtu, është zhvilluar një paketë modulare mbi mbrojtjen e fëmijëve, me përfshirjen e temave për parandalimin e ngacmimeve seksuale.

Arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë është ende në fazë zhvillimi, me përpjekje të vazhdueshme për të krijuar një sistem arsimor që ofron mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes ose aftësisë. Edhe pse janë bërë hapa të rëndësishëm në hartimin e politikave që synojnë integrimin e konceptit të gjithëpërfshirjes në politikat arsimore, zbatimi i tyre mbetet sfidues për shkak të burimeve të kufizuara dhe mungesës së infrastrukturës së përshtatshme. Një nga sfidat më të mëdha mbetet përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla. Përfshirja e tyre vazhdon të jetë në nivel të ulët dhe mësimdhënia ende nuk i përshtatet nevojave individuale të këtyre fëmijëve. Nga 1,044 institucione arsimore, vetëm 609 prej tyre kanë qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë 53 shkolla të ndërtuara midis viteve 2016 dhe 2023.¹¹⁴ Megjithatë raportohet se këto shkolla kanë qasje edhe në tualete, të dhënat specifike për qasjen në tualete nuk janë në dispozicion. Gjatë vitit shkollor 2022/2023, vetëm 3,903 fëmijë me aftësi të kufizuara ishin të përfshirë në klasat e rregullta, ndërsa 313 fëmijë me aftësi të kufizuara vazhdojnë mësimin në qendra burimore ose shkolla speciale.¹¹⁵



VETËM 3,903

FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA ISHIN TË PËRFSHIRË NË KLASAT E RREGULLTA

Shqetësime janë ngritur edhe lidhur me cilësinë e mësimdhënies në qendra burimore. Testi i shkathtësive të leximit tregoi se asnjë nga 14 nxënësit e testuar nga klasa 4 deri në 12 në Qendrën Burimore në Prizren nuk arrin të lexojë dhe kuptojë as edhe fjali të thjeshta, dhe arsyet kryesore për këtë janë mungesa e gjuhës së shenjave dhe shkathtësive pedagogjike të mësimdhënësve, mungesa e materialeve të përdorura në mësimdhënie, mungesa e angazhimit të përkthyesve të Gjuhës së Shenjave dhe mungesa e gjuhës së shenjave si lëndë për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.¹¹⁶

Për shkak të mungesës së statistikave zyrtare për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë, është e

¹¹² Gjendja dhe Cilësia e Mësimin në Shkollat e Vogla dhe në Paralelet e Ndara në kontekstin e organizimit të tanishëm të rrjetit të shkollave në Kosovë, Qendra për Arsim e Kosovës, 2023

¹¹³ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

¹¹⁴ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

¹¹⁵ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

¹¹⁶ Studim mbi nivelin e arritjeve të nxënësve me dëmtime në dëgjim në qendrën burimore Nëna Tereza në Prizren, Këshilli i Europës, 2023 <https://rm.coe.int/alb-study-on-the-level-of-academic-achievements/1680ad53ed>

pamundur të përcaktohet saktësia e përfshirjes së tyre në arsim. Mungesa e të dhënave përbën pengesë të madhe për planifikimin dhe përmbushjen e nevojave të këtyre fëmijëve.

Mbledhja e të dhënave bëhet edhe më e ndërlikuar për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet ministrive dhe mekanizmave ekzistues. Gjithashtu, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara shpesh përballen me mungesë informacioni dhe mbështetjeje. Mbështetja për këta prindër mbetet e kufizuar dhe e fragmentuar, duke u mbështetur kryesisht në iniciativa të organizatave të shoqërisë civile. Pa shërbime në nivel lokal, shumë prindër ndihen të paafte për të mbështetur fëmijët e tyre në zhvillimin psikosocial, rehabilitimin në shtëpi dhe përfshirjen e tyre në shkollë dhe komunitet.¹¹⁷

Edhe pse legjislacioni kërkon që çdo komunë të ketë ekipe për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, shpesh këta fëmijë identifikohen vetëm kur arrijnë moshën shkollore, duke u regjistruar vonë në shkollë, gjë që ndikon në zhvillimin e tyre. Shumica e komunave kanë krijuar ekipet për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, por jo të gjitha janë funksionale. Ka komuna të vogla që nuk kanë formuar ekipe të tilla për shkak të vështirësive financiare ose mungesës së kuadrit të nevojshëm.



RRETH 330

**ASISTENTË PËR FËMIJËT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA NË KOMUNA**

Nga viti 2021 deri më tani, Ministria e Arsimit ka bërë hapa pozitiv për të plotësuar nevojën për angazhimin e asistentëve mbështetës në institucionet e arsimit para universitar duke punësuar rreth 330 asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara në komuna. Mirëpo, ky numër i asistentëve mbështetës mbetet ende i pa mjaftueshëm për të përballuar kërkesat në rritje për mbështetje profesionale. Shkollat po ashtu kanë mungesë të stafit mbështetës si psikologë dhe pedagogë. Aktualisht janë 225 pedagogë dhe psikologë në shkolla, por nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit potencohet që mund të ketë edhe më shumë por që nuk janë përditësuar punësimet e

reja në sistem. Mbetet i nevojshëm zgjerimi i mëtejshëm i stafit mbështetës në shkolla për të përmbushur nevojat e të gjithë fëmijëve.

Përveç mungesës së shërbimeve psikologjike me bazë në shkollë, mungesa e të dhënave për gjendjen e shëndetit mendor të nxënësve në shkolla në nivel vendi është një problematikë tjetër qenësore e cila penalizon bindshëm procesin e hartimit të politikave dhe intervenimeve të bazuara në evidencë. Në anën tjetër, nga ato pak të dhëna ekzistuese që kemi, rezultatet tregojnë për prezencë shqetësuese të dhunës psikologjike në shkollat e Kosovës dhe dëshmojnë qartë nevojën për hulumtime dhe intervenime në këtë drejtim.

Sfidat e tjera që ndikojnë negativisht në arsimin gjithëpërfshirës janë: trajnimi joadekuat i mësimitdhënësve, mungesa e metodave të përshtatura për mësimitdhënien gjithëpërfshirëse, mungesa e pajisjeve teknologjike mbështetëse, normat dhe parajgykimet sociale, kurrikula dhe faktorët socio-ekonomik.

Në vitet e fundit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka ndërmarrë hapa konkrete për monitorimin dhe uljen e shkallës së braktisjes së shkollës në gjithë Kosovën. Të dhënat e ndara sipas komuniteteve mblidhen në nivel shkolle dhe kategorizohen në nivel komunal, po ashtu janë miratuar kornizat ligjore për ekipet parandaluese, dhe çdo vit organizohet java kundër braktisjes së shkollës. Megjithatë, braktisja e shkollës, largimi i hershëm, vijimi i parregullt dhe mosregjistrimi në arsimin e detyrueshëm vazhdojnë të jenë shqetësim për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, sidomos për vajzat dhe fëmijët me status të ulët socio-ekonomik. Ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, ekipet e OSBE-së në terren identifikuan mbi 150 raste individuale dhe grupe të braktisjes së shkollës për më shumë se 400 fëmijë (nga klasa I-IX nga të gjitha rajonet e Kosovës), të cilët ose e kanë braktisur shkollën, ose janë në rrezik për ta bërë këtë.¹¹⁸

Një nga sfidat kryesore për parandalimin e braktisjes është raportimi i ulët nga shkollat në kuadër të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH). Në vitin 2022-2023 janë raportuar gjithsej 81 raste në rrezik të braktisjes.¹¹⁹ Ekipet për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit në arsimin e detyruar, janë themeluar në shumicën e shkollave dhe komunave. Megjithatë, jo të gjitha janë plotësisht funksionale dhe as që të gjitha angazhojnë anëtarë të rinj pas skadimit të mandatit të anëtarëve.

¹¹⁷ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF

¹¹⁸ Raport mbi braktisjen e shkollës, Përtej numrave të braktisjes së arsimit të obligueshëm në sistemin e Kosovës 2020-2023, OSBE

¹¹⁹ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2023

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet edhe roli i qendrave mësimore, të cilat, sipas Udhëzimit Administrativ A19/2018, janë vendet ku ofrohet mësim plotësues dhe aktivitete edukativo-arsimore për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje në mësimnxënie. Këto qendra mësimore, të organizuara nga organizatat joqeveritare, shihen si një mbështetje kyçe për parandalimin e braktisjes shkollore, veçanërisht për fëmijët nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Edhe pse ka pasur rritje të buxhetit për Qendrat Mësimore krahasuar me disa vite përpara, ky financim vazhdon të mbetet i pamjaftueshëm për funksionimin tyre, gjë që kërcënon edhe mbylljen e tyre. Vonesat dhe pasiguria në zbatimin e Udhëzimit Administrativ 19/2018 kanë krijuar kushte të vështira për qendrat mësimore, duke u sjellë sfida të mëdha menaxherëve të tyre. Qendrat mësimore janë të bllokuara mes detyrimeve ligjore dhe mungesës së qartë të udhëzimeve procedurale. Pritjet e Qendrave mësimore dhe donatorëve për atë që do të realizohej me kornizën e re ligjore nuk janë përmbushur. Vonesat nga Ministria e Arsimit në ofrimin e udhëzimeve përkatëse për regjistrim dhe ndarje të fondeve nga qeveria dhe buxheti lokal kanë ndikuar në këtë situatë.¹²⁰ Implementimi i ngadalshëm i Udhëzimit Administrativ 19/2018 ka dobësuar besimin institucional, pasi Organizatat joqeveritare dhe përfaqësuesit e komunitetit vazhdojnë të shqetësohen për qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, një problem që institucionalizimi i tyre duhej ta adresonte. Ata janë ende të detyruar të kërkojnë mbështetje nga një numër i kufizuar donatorësh ndërkombëtarë për të vazhduar me shërbimet e tyre ose, në të kundërtën, detyrohen t'i ndërpresin tërësisht aktivitetet.¹²¹

Sa i përket përfshirjes së fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në arsim, për vitin shkollor 2022-2023, janë përfshirë 13,774 fëmijë nga familje me asistencë sociale, 4,002 fëmijë nga familje me një prind dhe 133 fëmijë pa asnjërin prind. Sidoqoftë, nuk ka të dhëna të sakta nëse institucionet kanë ndërmarrë masa për të adresuar nevojat e këtyre fëmijëve në arsim.¹²²

Shkollat publike në Kosovë ende nuk e përmbushin plotësisht konceptin e shkollave mike për fëmijët për shkak të mjedisit të pasigurt dhe jo miqësor, infrastrukturës së papërshtatshme, qasjes së mangët të mësimdhënësve, si dhe mungesës së personelit profesional, si pedagogë dhe psikologë. Po ashtu, bashkëpunimi me prindërit është i pamjaftueshëm, ndërsa mungojnë sallat dhe pajisjet sportive në disa shkolla, gjë që ndikon në zhvillimin e aktiviteteve sportive për nxënësit.¹²³ Aktivitetet sportive janë të domosdoshme për përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor, ndërtimin e aftësive sociale dhe emocionale, si dhe për përqendrimin dhe disiplinën, duke krijuar një ambient më të shëndetshëm dhe pozitiv në shkolla.

Sa i përket legjislacionit që ndërlidhet me arsimin, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka aprovuar Udhëzimet Administrative sikurse: Udhëzimin Administrativ për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie; Udhëzimin Administrativ për Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, Udhëzimin Administrativ për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve, Udhëzimin Administrativ për Kriteret dhe Procedurat e Aprovimit të Programeve për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Punonjësve Arsimore dhe Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve. Pritet që aprovimi i këtyre Udhëzimeve, t'i hapë rrugën proceseve të reja reformuese për të rritur cilësinë e mësimdhënies në institucionet e arsimit para universitar. Në këtë drejtim, Ministria e Arsimit duhet të monitorojnë me prioritet zbatimin e kornizës ligjore tashmë të aprovuar.

Sistemi arsimor në Kosovë ka nevojë për një qasje më gjithëpërfshirëse, e cila fokusohet në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, infrastrukturës dhe ndihmës për mësimdhënësit. Politikat arsimore duhet të jenë më të përshtatura me nevojat e nxënësve, dhe të rritet llogaridhënia, si dhe bashkëpunimi ndërmjet prindërve, mësuesve dhe komunitetit.

¹²⁰ Vështrim i përgjithshëm mbi qendrat mësimore në Kosovë dhe zbatimin e Udhëzimit administrativ nr. 19/2018, OSBE 2023

¹²¹ Vështrim i përgjithshëm mbi qendrat mësimore në Kosovë dhe zbatimin e Udhëzimit administrativ nr. 19/2018, OSBE 2023

¹²² Statistikat e arsimit në Kosovë 2022-2023, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimitne-kosove-2022-2023/>

¹²³ Të dhënat nga organizata anëtare Play International Kosovo, 2023

Rekomandime:

- » Investimi në ngritjen e cilësisë së arsimit;
- » Rishikimi i planprogramit mësimor, rishikimi i kurrikulave dhe rishikimi i teksteve shkollore;
- » Vlerësimi i performancës së mësimit dhe mbështetja dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm i mësimit;
- » Organizimi dhe realizimi i mësimit tërë ditë;
- » Rrjetëzimi i shkollave;
- » Krijimi i autonomisë së shkollave nga ndikimet politike;
- » Digjitalizimi i arsimit, aplikimi të metodave të mësimit që promovojnë përdorimin e teknologjisë në mësimit;
- » Pajisja e shkollave me mjete dhe materiale mësimore e teknologji digjitale që të sigurohet mbështetja e mësimit dhe të nxënësve;
- » Ofrimi i mjediseve miqësore, të shëndetshme e të sigurta, ku nxënësit gjejnë mbështetje nga mësimit dhe kanë pjesëmarrje aktive;
- » Zbatimi i Protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar;
- » Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në institucionet arsimore, si mjet kyç për të siguruar ambient të sigurtë dhe mbrojtës për fëmijët;
- » Integrimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative në shkollë, për përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor të fëmijëve dhe rritjen e gjithëpërfshirjes;
- » Themelimi apo funksionalizimi i komisioneve vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- » Rritja e numrit të mësuesve mbështetës, asistentëve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara ashtu sikurse është i paraparë në legjislacion;
- » Sigurimi i shërbimeve rehabilituese të integruara për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- » Largimi i barrierave fizike për të siguruar qasjen për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollë;
- » Trajnimi adekuat të mësimit për metodat e mësimit gjithëpërfshirëse;
- » Institucionalizimi i programeve/qendrave mësimore të cilat ofrojnë përkrahje në mësimit.



**DREJTËSIA
PËR TË MITUR**

DREJTËSIA PËR TË MITUR

Nota: 2

- ▶ Mungesë e shërbimeve parandaluese dhe rehabilituese për të miturit në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale
- ▶ Shkelje e dispozitave të Kodit për Drejtësi për të Mitur nga profesionistët në Qendër Korrektuese
- ▶ Mungesë e profesionistëve për rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturve në sistemin edukativ dhe korrektues



FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE



QENDRAT PËR PUNË SOCIALE, GJATË 2023 KANË PUNUAR GJITHSEJ ME 194 RASTE TË FËMIJËVE TË MITUR NË KONFLIKT ME LIGJIN NËN MOSHËN 14 VJEÇARE.¹²⁴

Krahasuar me vitin 2022, konstatohet rënie e konsiderueshme e numrit të fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë. Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës dhe Qendrave për Punë Sociale, ka një mungesë të theksuar të shërbimeve rehabilituese për këta fëmijë. Shërbimet për këtë grup të fëmijëve mungojnë edhe nga sektori joqeveritar. Në 2023, nuk ka patur asnjë qendër ditore të specializuar për të punuar individualisht

në rehabilitimin dhe reintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin nën moshën e përgjegjësisë penale. Në anën tjetër, as familjet strehuese nuk janë të specializuara dhe profilizuara për të strehuar këtë kategori të fëmijëve.

Prandaj, është e domosdoshme që institucionet të konsiderojnë me prioritet të lartë themelimin e shërbimeve të veçanta për fëmijët në konflikt me ligjin nën moshën e përgjegjësisë penale dhe prindërve apo kujdestarëve ligjor të tyre. Po ashtu, institucionet duhet të ndërmarrin hapa për themelimin e qendrave apo shtëpive të specializuara për trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, nën moshën e përgjegjësisë penale. Një mundësi, është përshtatja e dy Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës për nevojat e kësaj kategorie, nga shtatë Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës, të cilat janë paraparë të ndërtohen në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Institucionet duhet të ndërmarrin masa të menjëhershme për të fuqizuar shërbimet parandaluese dhe shtuar numrin e profesionistëve mbështetës në shkolla dhe Qendra për Punë Sociale, për fëmijët para moshës së përgjegjësisë penale.

¹²⁴ Të dhënat nga raporti i Ministrisë së Drejtësisë, 2023

FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN ME PËRGJEGJËSI PENALE



1,867

KALLËZIME PENALE TË KRYESVE TË MITUR TË VEPRAVE PENALE

Gjatë vitit 2023, numri i fëmijëve në konflikt me ligjin që është raportuar nga Policia e Kosovës, ka qenë 2175 fëmijë.¹²⁵ Ndërsa, gjatë vitit 2023, Prokuroritë Themelore kanë pranuar gjithsej 1,867 kallëzime penale të kryesve të mitur të veprave penale me 2,755 persona, ndërkohë që 680 kallëzime me 1,167 persona, janë bartur nga viti 2022. Rastet e pranuar në 2023, janë parashtruar në 98,1% të tyre, nga Policia e Kosovës. Në total, gjatë 2023 janë trajtuar 2,547 raste të kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale me 3,922 persona, nga të cilët Prokurorët e Drejtësisë për të Mitur kanë zgjidhur 1,390 raste me 2,123 persona dhe kanë bartur 1,157 raste për vitin 2024.¹²⁶

Numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur të pranuar gjatë 2023, është rritur me 285 kallëzime penale më shumë, ose me 18.00%, krahasuar me 2022.



18%

MË SHUMË KALLËZIME PENALE TË KRYESVE TË MITUR TË VEPRAVE PENALE, KRAHASUAR ME 2022.

Nga 1,390 të cilat janë zgjidhur gjatë 2023, për 402 ose 18.93% të personave të mitur, nuk ka filluar procedura përgatitore (parimi i oportunitetit); për 124 ose 5.84% të personave të mitur është propozuar procedura e ndërmjetësimi; për 109 ose 5.13% të personave të mitur është pushuar procedura përgatitore; për 239 ose 11.25% të tyre është hedhur kallëzimi penal; për 197 ose 9.27% është propozuar të shqiptohet masa e diversitetit; për 150 ose 7.06% është propozuar të shqiptohet masa disiplinore; për 609 ose 28.68% është propozuar të shqiptohet masa e mbikëqyrjes së shtuar; për 163 ose 7.67% është propozuar të shqiptohet masa institucionale; për 8 ose 0.37% është propozuar të shqiptohet gjoba; për 11 ose 0,51% është propozuar urdhri për punë në dobi të përgjithshme; për 8 ose 0.37% është propozuar të shqiptohet burgimi për të mitur; për 8 ose 0,37% është propozuar të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm; dhe për 95 ose 4.47%, të personave të mitur, rastet janë zgjidhur në mënyrë tjetër.¹²⁷

Ndërkohë që Gjykatat Themelore, bazuar në propozimet e prokurorëve, kanë marrë këto vendime ndaj 824 personave: Aktgjykime për shqiptimin e dënimit ndaj të miturve janë marrë ndaj 76 ose 9.22%, të personave; aktvendime për shqiptimin e masës edukative janë marrë ndaj 670 ose 81.31%, të personave; masa të diversitetit janë shqiptuar për 3 ose 0.36% të personave dhe aktvendime për pushimin e procedurës për të mitur janë marrë ndaj 75 ose 9.10% të personave.¹²⁸

Në 2023, numri i përgjithshëm i Prokurorëve të Drejtësisë për të Mitur ka qenë 12 prokurorë, në shtatë Prokuroritë Themelore. Departamentet për të Mitur brenda Prokurorive Themelore kanë pranuar mesatarisht 175.63 kallëzime – lëndë penale gjatë 2023, apo rreth 15.96 kallëzime – lëndë penale për prokuror. Duke qenë se norma mujore për prokuror është 5.96 kallëzime – lëndë penale, evidentohet se edhe Prokurorët e Drejtësisë për të Mitur kanë mbingarkesë të lëndëve me të cilat punojnë.

Gjatë vitit 2023 Shërbimi Sprovues i Kosovës ka përpunuar gjithsej 778 raste me të mitur në konflikt me ligjin¹²⁹, prej të cilëve 739 djem dhe 39 vajza. Prej tyre, 307 janë të moshës 14 – 16 vjeç dhe 440 të moshës 16 – 18 vjeç, gjë që dëshmon se mosha e të miturve që bien në konflikt me ligjin vijon të zbrësë pasi 39.5% prej tyre janë të grupmoshës deri 16 vjeç. Ky vit ka shënuar rritje të numrit të të miturve në konflikt me ligjin me 11,4%, krahasuar me vitin paraprak gjatë të cilit janë pranuar gjithsej 700 raste.

¹²⁵ Të dhënat nga Policia e Kosovës, 2023

¹²⁶ Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit, 2023

¹²⁷ Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit, 2023

¹²⁸ Të dhënat nga raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit, 2023

¹²⁹ Të dhënat nga raporti i Ministrisë së Drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, 2023

Nga totali i veprave të kryera, 449 janë kundërvajtje dhe 329 vepra penale, të cilat përbëjnë 42.3% të veprave të kryera.¹³⁰ Ky tregues flet për rritje të numrit të veprave penale të kryera nga të miturit. Prej totalit të 778 të miturve, vetëm 26 prej tyre janë recidivist ndërkohë që pjesa tjetër e të miturve e kanë kryer veprën për herë të parë.

Në veprat e kundërvajtjes, si vepra kryesore renditen prishja e rendit dhe qetësisë publike, komunikacioni dhe dëmtimi i pronës. Për këto raste gjykata ka dhënë vendim për mbikëqyrje të shtuar nga prindi, për 440 raste apo 98% të të gjithë rasteve të trajtuara. Ndërkohë që mes veprave penale, pjesa dërrmuese, rreth 69% janë vepra të paspecifikuara, kurse veprat e tjera penale që mbizotërojnë janë mbajtja e armëve, vjedhja, plagosja dhe shitja e drogës. Lidhur me posedimin dhe shitjen e substancave narkotike, të dhënat nga Policia e Kosovës raportojnë për 80 raste dhe 102 fëmijë të arrestuar gjatë vitit 2023, për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave narkotike. Po ashtu, gjatë 2023 numri total i personave të kategorizuar në moshë të mitur të cilët kanë rënë ndesh me ligjin për abuzim me droga, ka qenë gjithsej 74 persona, ku moshë me e re ka qenë 13 vjeç.¹³¹

Për këto raste gjykata në pjesën më të madhe ka shqiptuar vendimin e njëjtë për mbikëqyrje të shtuar nga prindi, për 249 apo 76% prej tyre. Qortimi gjyqësor është shqiptuar për 39 të mitur apo 11.9% të rasteve ndërkohë që masat e diversitetit janë dhënë vetëm për 14 të mitur. Shqiptimi i masave të diversitetit vijon të mbetet shumë i ulët duke reduktuar mundësinë e të miturve për të përfituar nga programet rehabilituese dhe reintegruese.

Gjatë vitit 2023, Shërbimi Sprovues ka pranuar 181 raste të reja me masa të diversitetit¹³² të cilat janë shqiptuar nga prokuroritë themelore. Krahasuar me vitin paraprak ku janë pranuar 387 raste për zbatim të këtyre masave, vihet re një rënie e ndjeshme e këtyre masave. Një nga sfidat më të mëdha për Shërbimin Sprovues të Kosovës, për zbatimin e masave të diversitetit, mbetet mungesa e ekspertizës profesionale, konkretisht mungesa e psikologëve nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj mase, si Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare apo spitalet regjionale. Kjo gjë ka krijuar vështirësi në zbatimin e masës së diversitetit “Këshillim Psikologjik”. Po ashtu edhe vështirësitë ekonomike të familjeve të këtyre të miturve, kanë pamundësuar zbatimin e disa masave që kërkojnë udhëtimin e të miturve në qendrat sprovuese për kontakt dhe këshillim.¹³³

Shërbimi Sprovues përballë me sfida për të realizuar zbatimin efektiv të masave të diversitetit për të mitur. Përveç sfidave për zbatimin e masës “Këshillim Psikologjik”, mungojnë tërësisht programet e veçanta të dedikuara për trajtimin e të miturve viktimë të abuzimit me substanca psikoaktive dhe mbështetja ekonomike në realizimin e procesit edukativ, që do të krijonte mundësinë e pjesëmarrjes së të miturve në aktivitete të lira dhe kurse të ndryshme plotësuese.¹³⁴

Shërbimi Sprovues i Kosovës bashkëpunon me shumë institucione si Qendrat për Punë Sociale, Qendrat e Shëndetit Mendor, Qendrat e Aftësisë Profesionale, Organizatat joqeveritare, etj. Megjithatë, përkundër trajnimeve të specializuara për zyrtarët sprovues, tryezave rajonale të diskutimit me pjesëmarrje të komunitetit, bashkëpunimit me akterët dhe organizatat partnere, dhe fushatave ndërgjegjësuere për rolin dhe rëndësinë e masave alternative, zbatimi i tyre konform legjislacionit në fuqi, mbetet sfida. Programet e nevojshme për parandalim, rehabilitim dhe reintegrim për këta të mitur, vazhdojnë të mungojnë.

Rritja e bashkëpunimit me institucionet lokale dhe organizatat me bazë në komunitet të cilat mund të mbështesin apo të ofrojnë shërbime të specializuara, mbetet thelbësore për të patur sukses në rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturve.

Gjatë vitit 2023 kanë qenë gjithsej 33 zyrtarë të shërbimit sprovues në të shtatë zyrat rajonale të Shërbimit Sprovues. Për pasojë, kjo ka shkaktuar një mbingarkesë të rasteve me të cilat një zyrtar sprovues punon, ku në 2023, numri i rasteve për një zyrtar ka qenë mesatarisht 105 raste,¹³⁵ përfshirë mbikëqyrjen dhe fazën përgatitore siç është hartimi i anketave sociale. Kjo mbingarkesë në punën me raste ka ndikuar dukshëm në rënien e cilësisë së përgjithshme të ofrimit të shërbimit për të miturit, duke ulur shanset e rehabilitimit dhe reintegrimit të suksesshëm të tyre.



NUMRI I RASTEVE PËR NJË ZYRTAR SPROVUES ËSHTË 105 RASTE

¹³⁰ Të dhënat nga raporti i Ministrisë së Drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, 2023

¹³¹ Të dhënat nga raporti i Policisë së Kosovës, 2023

¹³² Të dhënat nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, 2023

¹³³ Të dhënat nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, 2023

¹³⁴ Të dhënat nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, 2023

¹³⁵ Të dhënat nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, 2023

Shërbimi Korrektues i Kosovës, gjatë vitit 2023 ka pranuar gjithsej 123 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin, mbi moshën e përgjegjësishë penale. Masat kryesore të shqiptuara për të miturit në konflikt me ligjin me përgjegjësi penale, gjatë vitit 2023 ishin 19 raste me masë institucionale edukative korrektuese dhe një rast i të miturit të dënuar. Numri i të miturve në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan dhe Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan gjatë vitit 2023, ka qenë 123 të mitur, nga të cilët 103 të mitur në paraburgim, 1 i mitur i dënuar me burgim dhe 19 të mitur me masa edukuese korrektuese.¹³⁶ Ndërkohë, veprat dominuese të kryera nga të miturit ishin vrasja, lëndimi i rëndë dhe dhunimi të cilat në raport me veprat dominuese të viteve të mëparshme, janë më të rënda.

Ky ndryshim në natyrën e veprave penale të kryera nga të miturit përbën shqetësim lidhur me dhunën dhe agresivitetin në këtë grupmoshë. Kjo e dhënë mund të sugjerojë se ka një normalizim të dhunës si mënyrë për të zgjidhur konflikte mes adoleshentëve dhe të rinjve dhe se rritja e ekspozimit ndaj përmbytjeve të dhunshme mund të ketë lehtësuar normalizimin e këtyre sjelljeve.

Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan dhe Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan, punon me programe dhe shërbime të rehabilitimit, të cilat aplikohen për rehabilitimin e të miturve. Konkretisht, programet e aplikuara në këto institucione gjatë 2023 ishin: Programi arsimor (mësimi klasor, mësimi i mesëm i ulët, mësimi i mesëm, si dhe mundësia për programe universitare; programi Top-s, programi “Masat për Trajtimin e Vartësisë”; programi “Biseda për Ndryshim”; programet e Aftësive Profesionale dhe programet e aktiviteteve fizike.

Krahasuar me vitin paraprak kur në këto qendra janë aplikuar vetëm dy programe rehabilitimi, vihet re themelimin i programeve të reja për të fuqizuar dhe mbështetur të miturit drejt rehabilitimit dhe reintegrimit të suksesshëm të tyre.

Po ashtu, në kuadër të aftësimit profesional, në këto qendra ofrohen trajnime për hidraulik, elektrik, kurse flokësh, rrobaqepësi, ndërkohë që Qendra Edukuese ofron edhe kurse për kulinari, printim-dizajn, gjithashtu edhe kursi për IT. Megjithatë, edhe pse këto punëtorë kanë kushte shumë të mira për zhvillimin e aftësive të të miturve, ato janë jashtë funksionit si pasojë e mungesës së materialit të punës.¹³⁷

Institucionet duhet të marrin masa të menjëhershme për të siguruar materialet e nevojshme të punës, për të pajisur punëtoritë e aftësimit profesional të Qendrës Edukuese me materialet e nevojshme të punës, me qëllim të funksionalizimit të tyre, për zhvillimin dhe aftësimin profesional të të miturve.

Në të dy qendrat vazhdon të mbetet një numër totalisht i pamjaftueshëm i stafit profesional i cili është thelbësor për të realizuar rehabilitimin e të miturve, gjë që edhe nga vetë Shërbimi Korrektues konsiderohet si një sfidë kryesore për qëllimin që këto institucione dhe dhënia e masave kanë. Me këtë numër të vogël stafit profesional është e pamundur të ofrohet ndihma dhe mbështetja ndaj të miturve për të ndërprerë sjelljet recidiviste dhe për të mbrojtjen dhe aftësimin e tyre.



**VETËM NJË ZYRTAR SOCIAL
DHE NJË PSIKOLOG
PËR QENDRËN KORREKTUESE
DHE QENDRËN EDUKUESE**

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka raportuar se gjatë 2023, ka qenë vetëm një zyrtar social dhe një psikolog për të mbuluar të dy institucionet. Në Qendrën Edukuese, ka qenë një zyrtar për arsimim, një instruktor për aktivitete fizike dhe tre instruktorë për trajnime profesionale.¹³⁸ Ndërkohë që nuk ka asnjë edukator të punësuar në Qendrën Edukuese dhe atë Korrektuese, siç parashihet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Gjatë vitit shkollor 2023/24, në të dy qendrat ka filluar organizimi i mësimin special për klasat 1 deri 4, për të miturit

¹³⁶ Të dhënat nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, 2023

¹³⁷ Të dhënat nga “Raporti Monitorues për të Drejtat e Njeriut në Institucionet Korrektuese në Kosovë” QKRMT, 2023

¹³⁸ Të dhënat nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, 2023

që nuk dinë shkrim dhe lexim. Për disa të mitur është lejuar mësimi në shkolla publike si dhe ka filluar implementimi i programit “Masat për trajtimin e varësisë” për trajtimin e të miturve.

Ashtu si vitin e kaluar, vazhdon vendosja e të miturve me masë edukative në Qendrën Korrektuese, në vend të vendosjes së tyre në Qendrën Edukuese, në përputhje me vendimin e gjykatës. Në raportin vjetor monitorues për të Drejtat e Njeriut në Institucionet Korrektuese në Kosovë 2023, publikuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, citohet se në bazë të kriterëve për vendosje në këtë institucion, paneli multi – disiplinor jep rekomandim se cilët të mitur i plotësojnë kriteret për tu vendosur në Qendrën Edukuese, pavarësisht vendimit të gjykatës. Ndërkohë edhe të miturit të cilët bëjnë shkelje gjatë qëndrimit në Qendrën Edukuese, kthehen në Qendrën Korrektuese për të Mitur.¹³⁹

Shërbimi Korrektues duhet të ndjekë në mënyre rigoroze dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, dhe të ndryshojë procedurën aktuale të vendosjes së të miturve në Qendrën Korrektuese dhe atë Edukuese. Të miturit me masë edukative, duhen vendosur prej fillimit në Qendrën Edukuese, të krijuar posaçërisht për qëllimin e rehabilitimit të tyre.

Qendra Korrektuese për të Mitur vazhdon të mos ketë hapësira të ndara për vajzat e mitura, duke i lënë këto të fundit në qëndrim me të dënuarat madhore. Ndërkohë që në Qendrën Edukuese ekziston një pavijon për të miturat femra, i cili nuk është banuar asnjëherë me të mitura.

Stafi i Qendrës Edukuese i cili deri në vitin 2023 ka punuar me rroba civile, prej vitit 2023 i ka zëvendësuar ato me uniforma. Shërbimi Korrektues duhet ta kthejë vendimin e mëparshëm dhe stafi i angazhuar në këtë qendër që synon të rehabilitojë të miturit, të jetë sërish me veshje civile.¹⁴⁰

Qendra Edukuese Korrektuese dhe Qendra Korrektuese për të Mitur aktualisht menaxhohen nga i njëjti ekip, i cili fizikisht ndodhet brenda mjediseve të Qendrës Korrektuese. Për të mundësuar një funksionim më të mirë në të dy qendrat, rekomandohet ndarja e menaxhmentit dhe udhëheqja e secilës qendër me një menaxhment të veçantë.

¹³⁹ Të dhënat nga “Raporti Monitorues për të Drejtat e Njeriut në Institucionet Korrektuese në Kosovë” QKRMT, 2023

¹⁴⁰ Të dhënat nga “Raporti Monitorues për të Drejtat e Njeriut në Institucionet Korrektuese në Kosovë” QKRMT, 2023

Rekomandime:

- ▶▶ Themelimi i qendrave apo shtëpive të specializuara për trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, nën moshën e përgjegjësisë penale, duke përshtatur dy prej Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës për nevojat e kësaj kategorie, nga shtatë Shtëpitë të parapara në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës;
- ▶▶ Fuqizimi i shërbimeve parandaluese dhe rritja e numrit të profesionistëve mbështetës në shkollë dhe Qendra për Punë Sociale, për fëmijët para moshës së përgjegjësisë penale;
- ▶▶ Vendosja e të miturve me masë edukative në Qendrën Edukuese Korrektuese, në vend të vendosjes së tyre në Qendrën Korrektuese, në përputhje me vendimin e gjykatës;
- ▶▶ Rikthimi i veshjeve civile të stafit të punësuar në Qendrën Edukuese Korrektuese;
- ▶▶ Punësimi i stafit profesional si punëtorë social, psikologë, edukatorë, instruktorë profesional, etj., për të zbatuar programet individuale, programet rehabilituese dhe reintegruese për të miturit;
- ▶▶ Pajisja e punëtorëve të aftësisë profesionale të Qendrës Edukuese me materialet e nevojshme të punës, me qëllim të funksionalizimit të tyre, për zhvillimin dhe aftësimin profesional të të miturve;
- ▶▶ Ndarja e menaxhmentit të Qendrës Edukuese Korrektuese dhe Qendrës Korrektuese për të Mitur dhe udhëheqja e secilës qendër me një menaxhment të veçantë;
- ▶▶ Krijimi i formave nga Policia e Kosovës dhe unifikimi i praktikave për shqiptimin e masës së diversitetit “Vërejtje policore”;
- ▶▶ Organizimi i trajnimeve të rregullta për ngritjen e kapacitetit të profesionistëve të sistemit të drejtësisë për punën me fëmijë dhe masat e reja të diversitetit, sipas Kodit për Drejtësi për të Mitur;
- ▶▶ Zhvillimi i programit të ri kurrikular për fëmijët të Akademisë së Drejtësisë, për pjesën penale dhe pjesën civile.

ORGANIZATAT ANËTARE TË KOMF

- Aksioni për Nëna dhe Fëmijë
- Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim
- Balkan Sunflowers Kosova
- Childproof/CIPOF
- CONCORDIA Projekte Sociale
- Down Syndrome Kosova
- Education Comes First
- Handikos Ferizaj
- Handikos Gjakovë
- Hareja
- Network of Peace Movement
- Nevo Koncepti
- OPFAKKOS
- Organizata "Autizmi"
- Organizata Akti
- Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP
- Organizata Zë
- PLAY International
- Programi për të Drejtat Civile
- Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS
- Qendra e Kujdesit Ditor PEMA
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT
- Qendra Labyrinth
- Qendra për Arsim e Kosovës – KEC
- Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore
- Qendra për Studime të Avancuara – FIT
- Qendra Sociale Edukative SOS Kopshti
- Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë
- Save the Children në Kosovë
- SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
- Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS
- Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova
- Terre des hommes Kosovo
- The Ideas Partnership
- Voice of Roma, Ashkali and Egyptians – VoRAE

